VENDIM
Nr. 733, datë 20.10.2016

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR BARAZINË GJINORE DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT 2016-2020

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 10, të ligjit nr. 9970, datë 24.7.2008, "Për barazinë gjinore në shoqëri", me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe të Planit të Veprimit 2016-2020, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen të gjitha ministritë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

STRATEGJIA KOMBËTARE PËR BARAZINË GJINORE DHE PLANI I VEPRIMIT 2016-2020

Tiranë, Shtator 2016

Kjo strategji kombëtare dhe plani i saj i veprimit u përgatitën në emër të Qeverisë së Shqipërisë nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe ministritë e linjës, në konsultim me përfaqësues(e) të organizatave të shoqërisë civile, si dhe të organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare që punojnë për arritjen e barazisë gjinore, si dhe reduktimin e dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, në Shqipëri.

Hartimi i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planit të saj të Veprimit 2016-2020 u mundësua me mbështetjen teknike e financiare të OKB-së (UNDP dhe UN Women), përmes fondeve të Qeverisë Suedeze.

LISTA E SHKURTIMEVE

ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BE	Bashkimi Evropian
BGJ	Barazia Gjinore
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DHBGJ	Dhunë me bazë Gjinore
DHF	Dhunë në Familje
DHKG	Dhunë ndaj Grave
GNP	Grupi Ndërinstitucional i Punës
LBGJ	Ligji për Barazinë Gjinore
LDHF	Ligji për Masa ndaj Dhunës në Familje
INSTAT	Instituti i Statistikave në Shqipëri
IAL	Institucionet e Arsimit të Lartë
IOM	Organizata Ndërkombëtare e Migracionit
IZHA	Instituti i Zhvillimit të Arsimit
Konventa e CEDAW	Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
Konventa e Stambollit	Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sporteve
MD	Ministria e Drejtësisë
MKR	Mekanizmi Kombëtar i Referimit
MMSR	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MSHÇV	Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore
NJVQV	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
OJF	Organizatë Joqeveritare (Jo-fitimprurëse)

OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
PNUD	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
PKV	Plani Kombëtar i Veprimit
PSHSH	Policia e Shtetit Shqiptar
QSH	Qeveria e Shqipërisë
SKBGJ	Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore
SKBGJ-DHBGJ/DHF	Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore, Reduktimin e Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunës në Familje 2011 - 2015
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
UM	Urdhër Mbrojtjeje
UMM	Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtjeje
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UN Women	Entitet i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

HYRJE

Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore (SKBGJ) 2016-2020[1] dhe Plani i saj i Veprimit, hartuar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë me kontributin e Grupit Ndërinstitucional të Punës[2], përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile e organizatave ndërkombëtare që fokusohen në çështjet e barazisë gjinore dhe kundër dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje në Shqipëri[3], si dhe me mbështetjen e eksperteve të fushës, është konceptuar si një udhërrëfyes drejt një shoqërie të mundësive të barabarta e pa dhunë, në të cilën: nevojat e grave dhe burrave merren në konsideratë dhe trajtohen në mënyrë të barabartë; gratë respektohen, mbrohen, nxiten e mbështeten për të ecur përpara njëlloj si dhe burrat; vajzat e djemtë, rriten të lumtur e të gëzuar mes parimeve të barazisë e mosdiskriminimit - pra një shoqëri, që ka në bazë një familje të shëndoshë, komunitet mbështetës dhe institucione të konsoliduara, që zbatojnë legjislacionin dhe detyrimet e tyre me përgjegjshmëri.

Arritja e barazisë gjinore dhe reduktimi i dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje tashmë artikulohen qartësisht mes prioriteteve dhe drejtimeve kryesore për zhvillim, në një tërësi dokumentesh e programesh kombëtare, duke u konsideruar si kushte drejt një zhvillimi të qëndrueshëm. Përgatitja dhe miratimi i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2016-2020, është parashikuar edhe në kuadrin e politikave të planifikuara për periudhën 2016-2018 në "Planin Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2016-2020"[4].

Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2016-2020, e treta e këtij lloji në Shqipëri, mbështetet në objektivat e programit të Qeverisë së Shqipërisë për barazinë gjinore dhe luftën kundër dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, kuadrin ligjor kombëtar, si dhe detyrimet ndërkombëtare që rrjedhin nga konventat dhe marrëveshjet e ratifikuara në këtë fushë, duke i kushtuar kujdes të veçantë sigurimit të përputhshmërisë me politikat e Bashkimit Evropian në kuadër të proçesit të integrimit. Qëllimet strategjike, objektivat specifike dhe veprimet e propozuara bazohen gjithashtu edhe në rekomandimet e evidentuara në "Raport Vlerësimin: Zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, Reduktimin e Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunës në Familje dhe Planit të saj të Veprimit 2011-2015[5].

---

[1] Këtu e në vijim SKBGJ 2016-2020

[2] Sipas Urdhrit të Kryeministrit nr. 15 datë 21.01.2016 "Për ngritjen dhe funksionimin e grupit ndër-institucional të punës për hartimin e dokumentit strategjik për çështjet e barazisë gjinore 2016 - 2020"

[3] Lista e organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare të konsultura gjatë proçesit të hartimit të strategjisë dhe planit të saj të veprimit paraqiten bashkëlidhur këtij dokumenti.

[4] Parashikuar për t'u përfunduar dhe hyrë në fuqi në tremujorin e I-rë të vitit 2016. Për më shumë detaje lutemi referohuni tek "Plani Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2016-2020", Kapitulli 19, fq 591. Shiko: http://www.integrimi.gov.al/al/dokumenta/dokumente-strategjike/plani-kombetar-per-integrimin-europian-2016-2020&page=1

[5] "Raport vlerësimi: Zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, Reduktimin e Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunës në Familje 2011-2015 dhe Planit të saj të Veprimit", përgatitur nga A. Plaku, M.Kocaqi dhe mbështetur nga PNUD me fonde të Qeverisë Suedeze, tetor 2015. Përgatitja e këtij raporti u konceptua si fazë parapërgatitore për shkrimin e SKBGJ 2016-2020 dhe siç u ra dakort me MMSR, ky proces nuk do të konsistonte në një vlerësim të mirëfilltë por, në plotësimin e informacionit të nevojshëm kryesisht sa i takonte zbatimit të aktiviteteve të Planit të Veprimit 2011-2015 (duke qenë se gjatë vitit 2014 ishin hartuar dy raporte kombëtare katër vjeçare, paralelisht edhe me disa raporte të tjera vlerësimi, që preknin si çështjet e barazisë gjinore ashtu edhe situatën në lidhje me dhunën me bazë gjinore e dhunën në familje). Për më shumë detaje, lutemi referohuni tek informacioni dhe shpjegimet e dhëna në raportin e përgatitur.

Hartimi dhe zbatimi i dy strategjive të mëparshme[6] kanë evidentuar një angazhim dhe përfshirje gjithnjë e më në rritje të Qeverisë së Shqipërisë, në adresimin e këtyre çështjeve. Progres është shënuar veçanërisht në integrimin e barazisë gjinore në politikat publike, si dhe në përmirësimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e grave dhe vajzave nga abuzimi dhe dhuna. Duke u mbështetur në këto themele të forta, përpjekjet për të avancuar drejt barazisë gjinore dhe tolerancës zero kundër dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, do të synojnë përmirësimin e mëtejshëm të bashkërendimit me partnerët qeveritarë dhe aktorë të tjerë të interesuar (sidomos me organizatat e shoqërisë civile të angazhuara në mënyrë specifike për trajtimin dhe ofrimin e shërbimeve në lidhje me këto çështje), vënien në dispozicion të burimeve njerëzore e financiare për sigurimin e shërbimeve të mjaftueshme e të aksesueshme, si dhe ngritjen e mekanizmave monitorues efektivë e të qëndrueshëm. Eksperienca dhe hapat e hedhur ndër vite së bashku me gjetjet nga hulumtimet e kryera, qëndrojnë në themel të qëllimeve kryesore të kësaj strategjie.

Jetojmë në një shoqëri, ku pavarësisht ndryshimeve pozitive e progresit të arritur, sjelljet steriotipike paragjykuese dhe modelet që nxisin veprime të dhunshme e diskriminuese, nuk mungojnë në përditshmërinë tonë. Ndaj dhe hapat e planifikuara për t'u zbatuar për pesë vjeçarin në vijim, tërheqin vëmendjen drejt harmonizimit të mëtejshëm të legjislacionit kombëtar me atë ndërkombëtar; garantimin e trajtimit të barabartë e pa diskriminim të të gjithë individëve në shoqëri; marrjen në konsideratë dhe trajtimin me prioritet të nevojave të grupeve vulnerabël (sidomos të grave kryefamiljare, grave të dhunuara, grave me aftësi të kufizuara, vajzave-nëna, grave rome dhe egjiptiane, grave të moshuara, grave LBT); zgjerimin e gamës së shërbimeve të ofruara dhe përmirësimin e efektivitetit të tyre në përputhje me standardet e kërkuara; sigurimin e mbrojtjes së menjëhershme dhe trajtimit afatgjatë të të gjithë anëtarëve në familje të dëmtuar nga dhuna e ushtruar; përgatitjen e një gjenerate të re mendjehapur, pa paragjykime e steriotipe gjinore, si dhe tërësisht kundër dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje.

Metodologjia e përdorur për hartimin e SKBGJ 2016-2020, si dhe struktura e dokumentit dhe Planit të Veprimit janë në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2015-2020", miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 348 datë 11.05.2016, si dhe me dokumentet e tjera strategjike sektoriale 2013-2020 në kuadër të SKZHI-së.

Parimet kryesore që udhëheqin këtë strategji janë:

- ***Barazia gjinore, kusht për një shoqëri të drejtë e socio-ekonomikisht të zhvilluar*** - njohja dhe respektimi i barazisë gjinore; përmirësimi i statusit social, ekonomik dhe shëndetësor i vajzave/grave dhe sidomos i vajzave/grave që pësojnë diskriminim të shumëfishtë[7]; edukimi, përparimi dhe angazhimi politik i tyre duke iu ofruar mundësi të barabarta njëlloj si dhe djemve/burrave, janë parakushte për zhvillimin e gjithanshëm të vendit.
- ***Ndjeshmëri dhe trajtim i barabartë ndaj nevojave të veçanta të të dy gjinive*** – vajzat/gratë dhe djemtë/burrat kanë nevoja të ndryshme dhe përballen me forma të ndryshme të dhunës e diskriminimit. Prandaj dhe veprimet e parashikuara duhet të ofrojnë mundësi

[6] Konkretisht Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe kundër Dhunës në Familje 2007 – 2010 dhe Plani i saj i Veprimit, si dhe Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore, Reduktimin e Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunës në Familje 2011 – 2015 dhe Plani i saj i Veprimit.

[7] Kupto gra dhe vajza me aftësi të kufizuara, rome, egjiptiane, të moshuara, emigrante, vajzat-nëna, LBT, etj

për trajtimin në përshtatje me këto nevoja dhe përvoja – barazia nuk duhet ngatërruar me njëtrajtshmërinë: jemi të ndryshëm, por duhet të jemi të barabartë, jo të ngjashëm.

- ***Njohja, vlerësimi dhe respektimi i diversitetit*** - ndërmjet vajzave dhe grave, djemve dhe burrave, për sa i përket moshës, aftësisë, orientimit seksual, identitetit gjinor, origjinës etnike dhe shoqërore, praktikave fetare dhe zgjedhjeve jetësore.
- ***Tolerancë zero kundrejt dhunës ndaj grave e dhunës në familje*** - mbrojtja e jetës, dinjitetit dhe integritetit njerëzor, është parakusht për zhvillimin e një vendi: çdo formë dhune është sulm mbi dinjitetin njerëzor dhe shkelje e të drejtave të njeriut, ndaj nuk duhet të tolerohet.
- ***Koordinimi dhe bashkëpunimi ndër-institucional*** – nisur nga karakteristikat dhe natyra ndërsektoriale e çështjeve që përbëjnë shtyllat e kësaj strategjie, institucionet shtetërore, organizatat e shoqërisë civile, media, sektori privat, institucionet fetare, organizatat ndërkombëtare si dhe të gjithë aktorët dhe partnerët e interesuar, duhet të punojnë së bashku duke koordinuar veprimet për të adresuar sa më efektivisht pabarazitë dhe padrejtësitë me bazë gjinore për gratë/vajzat dhe burrat/djemtë.

SITUATA AKTUALE

Përpjekjet e Qeverisë së Shqipërisë në drejtim të arritjes së barazisë gjinore dhe reduktimit të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, e kanë përmirësuar situatën në vend dhe qëndrimet/perceptimet në lidhje me këto çështje. Kuadri ligjor për nxitjen e zhvillimit të mëtejshëm të barazisë gjinore dhe garantimin e gëzimit të të drejtave të njeriut të të gjithë shtetasve shqiptarë, pavarësisht nga gjinia, gjithashtu është përmirësuar ndjeshëm[8], sidomos gjatë zbatimit të SKBGJ-DHBGJ&DHF 2011-2015 dhe Planit të saj të Veprimit.

Në qeverinë e krijuar pas zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2013, përfaqësimi i grave është rritur në mënyrë të konsiderueshme, me 8 Ministre (ose 42%) dhe 10 Zëvendësministre (ose 34.4%). Përqindja e grave në Parlament është rritur nga 18% në 22.9% në vitin 2015 (32 gra nga 140 deputetë gjithsej)[9]. Ende nuk është plotësuar objektivi i rritjes së pjesëmarrjes së grave në parlament në 30%. Roli i deputeteve gra u fuqizua me krijimin e Aleancës së Grave Deputete (AGD) në 2013, një grup që inkurajon integrimin gjinor të ligjeve dhe promovimin e barazisë gjinore.

Shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore për popullsinë meshkuj dhe femra të moshës 15-64 vjeç është përkatësisht 72,2% dhe 51,3% (Meshkuj dhe Femra 2015, INSTAT). Mes popullatës me meshkuj dhe femra ekziston një hendek prej 20,9 pikë për qind në normën e pjesëmarrjes në forcat e punës. Sipas INSTAT (2015 a), kjo do të thotë se meshkujt janë më aktivë në tregun e punës në krahasim me femrat. Objektivi i rritjes së pjesëmarrjes së forcave të punës të grave deri në 65% nuk është arritur ashtu siç pritej.

Struktura e punësimit sipas statusit të punësimit tregon se 42,6% e të punësuarve janë punonjës, 31,8% janë punonjës kontribues në familje dhe 25,6% janë të vetëpunësuar (Meshkuj dhe Femra 2015, INSTAT). Midis të vetëpunësuarve dhe punonjësve, meshkujt dominojnë me përkatësisht 57,2% dhe 70,5%. Ndërkohë, femrat kanë 1,3 herë më shumë gjasa se meshkujt që të jenë punonjëse kontribuese në familje, një situatë që i vendos ato në varësi ekonomike dhe pengon fuqizimin e tyre ekonomik.

Harmonizimi i legjislacionit kombëtar me standardet dhe kërkesat ndërkombëtare është një nga angazhimet e ndërmarra nga Qeveria e Shqipërisë përmes ratifikimit të disa konventave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe veçanërisht i konventave që adresojnë në mënyrë specifike të drejtat e grave dhe vajzave. Ky proces gjithashtu bazohet edhe në nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) në vitin 2006. Barazia është një prej objektivave dhe detyrave, si dhe pjesë përbërëse e Traktatit të KE-së dhe Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së. Detyrimet e Shqipërisë për integrimin e çështjeve gjinore rrjedhin edhe nga pesë fushat prioritare të shprehura në "Strategjinë për barazinë mes grave dhe burrave 2010 - 2015" të Komisionit Evropian[10]. Veprimet e ndërmarra në këtë drejtim ndikojnë në trajtimin më të mirë të

---

[8] Detajet në lidhje me përmirësimin e kuadrit ligjor paraqiten në "Raportin Kombëtar për Zbatimin e Platformës për Veprim Pekin + 20", Prill 2014, botuar në
http://www.sociale.gov.al/files/documents_files/Raporti_Final_Pekin+20_dt_30.04.2014.pdf

[9] Të dhënat për vitin 2015 – burimi: Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Sektori i Barazisë Gjinore.

[10] "Raporti Kombëtar për Zbatimin e Platformës për Veprim Pekin + 20", Prill 2014 (fq 3-4), botuar në http://www.sociale.gov.al/files/documents_files/Raporti_Final_Pekin+20_dt_30.04.2014.pdf

nevojave gjinore të grave/vajzave dhe burrave/djemve në shoqëri. Në këtë kuadër një tërësi ligjesh, politikash, strategjish e programesh sektoriale janë rishikuar dhe përmirësuar nga perspektiva gjinore, siç paraqiten në mënyrë të detajuar edhe në "Raportin Kombëtar për Zbatimin e Platformës për Veprim Pekin + 20"[11]. Megjithatë, duhet të ndërmerren hapa të mëtejshëm, për zbatimin e suksesshëm të legjislacionit e politikave të përmirësuara. Rreziku i hartimit të politikave ose strategjive të reja të pandjeshme nga këndvështrimi gjinor duhet të shmanget, ndaj dhe përdorimi i analizës gjinore si instrument vlerësimi, përpara ndërhyrjeve të tilla për të gjitha grupet në nevojë, është domosdoshmëri. Po kështu proceset/mekanizmat e rregullta monitoruese, për të evidentuar se si janë përmbushur nevojat e grave/vajzave dhe burrave/djemve ende mungojnë.

Edhe strukturat përbërëse të Mekanizmit Kombëtar të Barazisë Gjinore kanë nevojë të fuqizohen dhe të kenë qëndrueshmëri. Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore (KKBGJ) duhet të luajë një rol më të dukshëm për përcaktimin e politikave shtetërore në fushën e barazisë gjinore, realizimin e integrimit gjinor, si dhe monitorimin e zbatimit të politikave, në fushën e barazisë gjinore dhe kundër dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje. Për më tepër, pas hyrjes në fuqi të Konventës së Stambollit, KKBGJ është edhe organi përgjegjës për bashkërendimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe masave për të parandaluar dhe luftuar të gjitha format e dhunës, të mbuluara nga kjo Konventë. Sektori i Barazisë Gjinore në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë[12], i cili është shërben njëkohësisht edhe si Sekretariati i Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore (KKBGJ) nuk mund të funksionojë me efikasitet maksimal për shkak të kapaciteteve të kufizuara (njerëzore dhe financiare). Rrjeti i Nëpunësve Gjinorë (NGJ) në nivel qendror dhe të vetëqeverisjes vendore, edhe pse një detyrim ligjor për t'u përmbushur[13], ende nuk mund të konsiderohet i konsoliduar: në nivel qendror flitet për Pika Fokale të Barazisë Gjinore[14] (pra punonjës që nuk i dedikohen me kohë të plotë këtij pozicioni), ndërsa në nivel të vetëqeverisjes vendore pjesërisht për Nëpunës Gjinorë[15] të cilët përmbushin edhe një sërë detyrimesh e rolesh të tjera.

Në shtator 2015[16] me Urdhër të Kryeministrit u vendos të merren masa institucionale dhe operacionale për zbatimin e një **qasjeje sektoriale të integruar** në kuadër të Sistemit të Planifikimit të Integruar, i cili përbën sistemin kryesor vendim-marrës që përcakton drejtimin strategjik dhe shpërndarjen e burimeve të vendit. Mekanizmi i Menaxhimit Sektorial të

---

[11] Prill 2014. http://www.sociale.gov.al/files/documents_files/Raporti_Final_Pekin+20_dt_30.04.2014.pdf

[12] Riorganizuar dy herë, në vitin 2013 dhe në vitin 2015

[13] Në zbatim të Ligjit nr. 9970, datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri" (nenet 13 dhe 14) , botuar në Fletoren Zyrtare nr. 125 datë 01.08.2008.

[14] Rrjeti i NGJ në nivel qendror përbëhet nga 18 persona kontakti (pika fokale) në ministritë e linjës, në Kryeministri dhe Departamentin e Administratës Publike - përshkrimi i punës së të cilëve është përmirësuar me detyra dhe përgjegjësi të veçanta në lidhje me barazinë gjinore dhe dhunën me bazë gjinore e dhunën në familje. Burimi i të dhënave: MMSR, Sektori i Barazisë Gjinore, Prill 2016

[15] 44 Bashki (nga 61) kanë deklaruar se kanë të emëruar NGJ të cilët njëkohësisht luajnë edhe rolin e koordinatorit vendor kundër dhunës në familje, si dhe mbulojnë një sërë detyrimesh të lidhura me nevojat e personave me aftësi të kufizuara, komunitetin rom dhe egjiptian, komunitetin LGBT, njësitë për mbrojtjen e fëmijëve, etj. Burimi i të dhënave: MMSR, Sektori i Barazisë Gjinore, Prill 2016

[16] Urdhër i Kryeministrit nr. 129 datë 21.09.2015 "Për marrjen e masave institucionale dhe operacionale për zbatimin e qasjes sektoriale dhe krijimin e grupeve të menaxhimit të integruar të politikave"

Integruar[17] përbëhet nga **Grupet e Menaxhimit të Integruar të Politikave** (GMIP)[18]. GMIP siguron instrumentin transparent dhe të koordinuar për mbikëqyrjen e zhvillimit dhe zbatimit të politikave në sektorët prioritarë, si dhe mekanizmin e duhur për të aksesuar fondet e nevojshme nga buxheti i shtetit ose nga burime të huaja për zbatimin e masave të politikave[19]. Nën-grupet Tematike përdoren nga GMIP për të lehtësuar zbatimin e programit vjetor të punës duke mbështetur punën për një temë ose detyrë të veçantë. ***"Përfshirja Sociale (përfshirë barazinë gjinore)"*** është Nën-grupi Tematik i katërt i GMIP për "Punësimin dhe Sektorin Social". GMIP e pilotuar në këtë fushë do të luajë një rol tepër të rëndësishëm sa i takon monitorimit të zbatimit të politikave e strategjive jo vetëm në lidhje me punësimin por, edhe me çështje të tjera sociale, përfshirë këtu dhe çështjet e barazisë gjinore e reduktimit të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, në koordinim dhe bashkëpunim të ngushtë me Sektorin e Barazisë Gjinore në MMSR.

Në drejtim të parandalimit dhe reduktimit të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, megjithëse ka pasur përmirësime sidomos në kuadrin ligjor, Shqipëria ende duhet të ndërmarrë një sërë veprimesh për përmbushjen e kërkesave të konventave ndërkombëtare të ratifikuara, si dhe për të treguar tolerancë zero ndaj dhunës. Përvojat pozitive ekzistuese për bashkëpunimin efikas të mekanizmave ndër-institucionalë nuk reflektohen në të njëjtin nivel efikasiteti tek të gjitha bashkitë ku janë ngritur këto mekanizma. Për më tepër, ngritja e mekanizmave dhe formalizimi i tyre është vetëm një hap i parë, i cili duhet patjetër të ndiqet nga plane konkrete për përmirësimin e funksionimit dhe sigurimin e qëndrueshmërisë së tyre, duke mos harruar rëndësinë e planifikimit dhe alokimit të mjeteve financiare të domosdoshme në këtë drejtim. Boshllëqet e njohurive të ofruesve të shërbimeve rreth kuadrit ligjor apo standardeve kombëtare vështirësojnë menaxhimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje. Jo të gjithë ofruesit e shërbimeve sigurojnë shërbime falas, në shumë gjuhë, të disponueshme në nivel kombëtar dhe të përshtatura sipas nevojave specifike të grupeve - këto standarde duhet të merren në konsideratë gjatë investimit për përmirësimin dhe zgjerimin e mëtejshëm të shërbimeve ekzistuese, si dhe për pilotimin e shërbimeve të reja.

Përmirësimi i legjislacionit nga këndvështrimi gjinor dhe përfshirja në të e formave të ndryshme të dhunës ndaj grave, ende të patrajtuara, merr një rëndësi të veçantë sidomos në kuadër të reformës në drejtësi. Kjo reformë që do të çojë në përmirësimin e një sërë ligjesh të rëndësishme, duhet të garantojë ndjeshmëri gjinore dhe përputhshmëri me standardet ndërkombëtare dhe ato rajonale.

Puna e deritanishme

Në vijim të situatës së përgjithshme të përshkruar më sipër, vlen të theksohet puna dhe përpjekjet e vazhdueshme të shtetit shqiptar së pari për të evidentuar nevojat dhe boshllëqet, e më pas edhe për të marrë masa për adresimin apo përmirësimin e tyre. Kështu, sidomos gjatë viteve të fundit

---

[17] Ky mekanizëm synon zhvillimin, zbatimin dhe monitorimin e reformave sektoriale në Shqipëri, nëpërmjet hartimit të programeve kombëtare sektoriale dhe krijimit të një liste të vetme të projekteve prioritare për investime strategjike, në perputhje me prioritetet e qeverisë, Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) dhe strategjite sektoriale, procesin e programit buxhetor afatmesëm (PBA), procesin e anëtarësimit në BE dhe detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë.

[18] Ose Integrated Policy Management Group (IPMG). GMIP janë ngritur dhe pilotuar fillimisht në katër fusha: (1) menaxhimi i integruar i ujit; (2) punësimi dhe sektori social (3) konkurrueshmëria dhe inovacioni; (4) mirëqeverisja dhe administrimi publik. Gjatë vitit 2016, pritet që GMPI-të të shtrihen edhe në sektorë të tjerë.

[19] Shiko: "Udhëzues për hartimin e Grupeve të Menaxhimit të Integruar të Politikave", kapitulli 2, fq 4, Shtator 2015

janë ndërmarrë një sërë iniciativash analizuese e vlerësuese, ndër të cilat mund të përmendim: "Analiza e legjislacionit në fushën e barazisë gjinore dhe dhunës në familje, nga këndvështrimi gjinor dhe vlerësimi i përputhshmërisë me dokumentet ndërkombëtarë" (2013-2015)[20]; "Raporti Kombëtar për Zbatimin e Platformës për Veprim të Pekin +20"(2014)[21]; "Raporti i IV-rt Periodik Kombëtar mbi Zbatimin e Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave" (2014)[22]; "Raport përfundimtar: Analizë e funksionimit të Reagimit të Koordinuar të Komunitetit ndaj dhunës në familje në nivel vendor në Shqipëri" (2015)[23], "Mekanizmat kundër dhunës dhe trafikimit: Sinergjitë dhe zhvillimet e sinergjive" (2015)[24]; Studimi "Shqipëria - Raporti përfundimtar: Hartëzimi i shërbimeve mbështetëse kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave" (2015)[25]; "Udhërrëfyesi për zbatimin e Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje"(2013)[26], Studimi "Dhunë e padukshme - një vështrim mbi fenomenin e dhunës ndaj grave e vajzave me aftësi të kufizuara në Shqipëri" (2015)[27], Studimi "Zvogëlimi i dhunës ndaj grave me fokus komunitetin LBT në Shqipëri" (2015)[28], Studimi mbi "Forcimin e rolit të grave këshilltare në Këshillat Bashkiakë në Shqipëri" (2016)[29], Studimi mbi "Perceptimet dhe qëndrimet publike ndaj barazisë gjinore në Shqipëri" (2016)[30], etj. Gjetjet nga këto studime e raporte, si dhe nga një sërë analizash e vlerësimesh të ndërmarra edhe nga organizatat e shoqërisë civile, evidentojnë më së miri drejtimet kryesore ku duhet të fokusohet puna në vijim.

---

[20] Realizuar me mbështetjen e Agjensive të Kombeve të Bashkuara dhe rishikuar me mbështetjen e PNUD me fonde të Qeverisë Suedeze, edhe në kuadër të Reformës aktuale në Drejtësi.

[21] Përgatitur nga MMSR në emër të Qeverisë së Shqipërisë.
http://www.sociale.gov.al/files/documents_files/Raporti_Final_Pekin+20_dt_30.04.2014.pdf

[22] Dorëzuar në Komitetin e Konventës në nëntor 2014. http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2014/PDF-2014/187-2014.pdf

[23] Përgatitur nga E. Metaj, realizuar me mbështetjen e PNUD Shqipëri me fonde të Qeverisë Suedeze, 3 qershor 2015. Shiko: http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/poverty/functioning-of-the-coordination-mechanism-for-referral-and-treat.html

[24] Përgatitur nga V. Lenja, gusht 2015. me mbështetjen e Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), në kuadër të "Programit të Kombeve të Bashkuara për Përfshirjen Sociale në Shqipëri", financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim,http://www.punetebrendshme.gov.al/files/priorities_files/15-08-31-07-39-24Mekanizmat_kunder_dhunes_dhe_trafikimit_-_Raport.pdf

[25] Përgatitur nga Prof. Dr. L. Kelly, Dr. J. Lovett, Msc. M. Kocaqi, qershor 2015 me mbështetjen e Këshillit të Evropës dhe UN Women, si pjesë e bashkëpunimit të vazhdueshëm të dy organizatave për të nxitur nënshkrimin, ratifikimin dhe zbatimin e Konventës së Këshillit të Evropës për Parandaliminin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit). Raporti pritet të botohet gjatë vitit 2016.

[26] Përgatitur nga Prof. Dr. A.C.Baldry, Msc. M. Agolli, Msc. M. Kocaqi, Msc. A. Plaku, 2013.Realizuar me mbështetjen teknike të UN Women Shqipëri, në kuadër të Programit të Bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara 2012-2016, me fonde të Qeverië Suedeze. Shiko: http://www.un.org.al/editor-files/file/Roadmap%20%20Costing%20of%20the%20CoE%20Convention.pdf

[27] Përgatitur nga Dr. B.Çani, Dr. N. Ballhysa, Mgr. S.Fortuzi, F.Kalemi, dhjetor 2015. Realizuar nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara me mbështetjen e PNUD, me fonde të Qeverisë Suedeze. Shiko: file:///C:/Users/user/Downloads/disabilities%20shqip.pdf

[28] Përgatitur nga PhD. B.Balli, nëntor 2015. Realizuar nga Aleanca LGBT Shqipëri, me mbështetjen e UN Trust Fund. Shiko: http://historia-ime.com/wp-content/uploads/2015/12/Libri-Shqip.pdf

[29] Përgatitur me mbështetjen e PNUD me fonde të Qeverisë Suedeze, shiko
http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/poverty/study-strengthening-the-decision-making-power-of-councilwomen-in/

[30] Përgatitur nga Dr. M. Dauti, Dr. E. Zhllima, Janar 2016, me mbështetjen e PNUD me fonde të Qeverisë Suedeze. Shiko: file:///C:/Users/user/Downloads/STUDIMI_PERCEPTIMET_SHQIP.pdf

Qeveria e Shqipërisë ka vijuar përpjekjet e saj për të trajtuar steriotipet gjinore me anë të luftimit të traditave dhe praktikave të dëmshme që shkelin të drejtat e grave dhe vajzave. Fushatat e koordinuara të rritjes së ndërgjegjësimit publik organizohen çdo vit me anë të përfshirjes së institucioneve shtetërore në nivel qendror dhe të vetëqeverisjes vendore, organizatave të shoqërisë civile dhe organizatave ndërkombëtare. Angazhimi i burrave dhe djemve si partnerë dhe aleatë të grave dhe vajzave në përpjekjet kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje po bëhet një prioritet.

Masa të vazhdueshme po ndërmerren edhe për përmirësimin e shërbimeve dhe standardeve të tyre për viktimat/të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Përvoja pozitive e koordinimit ndërmjet shumë agjencive/organizatave (Mekanizmi i Referimit) aplikuar tashmë në rreth 29 bashki të vendit[31], duhet shtrirë më tej, por duke marrë në konsideratë dhe adresuar edhe çështjen e efikasitetit të këtyre mekanizmave. Shërbimet e strehimit listohen gjithashtu si prioritet: një strehëz kombëtare shtetërore është hapur përveç strehëzave të ngritura nga OJF-të ofruese të shërbimeve[32], por standardet e BE-së për numrin e shtretërve të disponueshëm nuk janë plotësuar ende. Po kështu shërbimet e strehimit mbeten ende të paaksesueshme për disa nga grupet e grave, sidomos gratë me aftësi të kufizuara, gratë me probleme të shëndetit mendor, gratë me varësi nga substanca të ndryshme, gratë e moshuara, gratë LBT, etj – kjo si për shkak të mos përshtatshmërisë infrastrukturore, ashtu edhe për shkak të mungesës së stafit të kualifikuar për trajtimin e këtyre grupeve të grave në qendrat ekzistuese, etj. Është evidentuar si domosdoshmëri edhe ngritja e strehëzave për rastet emergjente (qendrat e krizës)[33], ku sërish duhet të mbahet në konsideratë nevoja për trajtimin e rasteve për të gjitha grupet e grave.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar përmirësimit të kapaciteteve të profesionistëve, ku ministritë e linjës dhe institucionet e tyre të vartësisë janë mbështetur edhe nga organizatat ndërkombëtare, si dhe OJF-të kombëtare/lokale. Kryesisht është punuar për përmirësimin e kapaciteteve të punonjësve të policisë[34], shëndetësisë[35], drejtësisë[36], antarëve të Ekipeve Teknike Ndërdisiplinare[37] dhe qendrave që ofrojnë shërbime[38] për rastet e dhunës në familje, etj.

---

[31] Burimi : MMSR, Sektori i Barazisë Gjinore, Prill 2016

[32] Nga Studimi: "Shqipëria - Raporti përfundimtar: Hartëzimi i shërbimeve mbështetëse kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave", rezulton se: ... "9 ofrues shërbimesh (ose 12.9%) janë përgjigjur se shërbimi i tyre përfshin strehimin, ndërsa një tjetër ofrues shërbimi është në proçes të hapjes së një strehëze, gjatë vitit 2015 . Nga totali i 9 strehëzave ekzistuese, 1 është ngritur vetëm për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe 1 është ngritur vetëm për personat LGBTI. Këto strehëza ekzistuese , sigurojnë gjithsej 153 shtretër për gratë dhe fëmijët e tyre viktima/të mbijetuara të dhunës, dhe numri i personave që mund të akomodohen njëkohësisht në secilën prej tyre varion nga 5 - 50 persona . Me qëllim që të plotësohet standarti minimal i kërkuar nga Konventa e Stambollit (1 shtrat në dispozicion për çdo 10,000 banorë) Shqipëria duhet të sigurojë edhe 137 shtretër të tjerë . Nëse marrim në konsideratë edhe numrin prej 10 shtretërish që do të vihen në dispozicion së shpejti, pasi të hapet strehëza e re në Shkodër, mbeten akoma edhe ***127 shtretër për t'u siguruar...***".

[33] Po aty.

[34] Raporti vlerësimi "Zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, Reduktimin e Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunës në Familje 2011-2015 dhe Planit të saj të Veprimit": 2011-2015: 648 punonjës policie të trajnuar , nga të cilët 224 punonjës policie u trajnuan gjatë periudhës janar-qershor 2014 (62 gra), me mbështetjen e Qeverisë Suedeze.

[35] Po aty: 2010-2013: Nga Projekti me titull "Ndërtimi i Kapaciteteve të Profesionistëve Shëndetësorë për Reagimin Efikas ndaj Nevojave të Viktimave të DHBGJ-së" i zbatuar nga NCES në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Departamentet e Shëndetit Publik, mbështetur nga UNFPA, u trajnuan 4400 profesionistë të kujdesit shëndetësor nga 12 rajone (1275 gra në 2010, 730 gra në 2011 dhe 1067 gra në 2013). Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe DHF- janë emëruar pranë Departamenteve të Shëndetit Publik të të gjitha rretheve.

Aktualisht është në proces vënia në funksionim e Linjës Telefonike të Këshillimit për viktimat e dhunës në familje[39], standartet e funksionimit të së cilës janë përfunduar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë me mbështetjen e PNUD. Linjat telefonike lokale[40] si dhe qendrat e këshillimit[41] ekzistuese gjithashtu kanë nevojë për ndërhyrje e mbështetje, pasi nuk janë gjithmonë të disponueshme 24 orë në 7 ditë të javës, nuk janë gjithmonë falas, si dhe nuk ofrojnë shërbime në gjuhë të ndryshme. Gjatë vënies në funksionim apo fuqizimit të këtyre shërbimeve, duhet të mbahet në konsideratë edhe detyrimi për ofrimin e informacionit në përshtatje me nevojat e grupeve të veçanta.

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, me mbështetjen e PNUD, ka krijuar një sistem elektronik kombëtar të rregjistrimit të rasteve të dhunës në familje[42], që trajtohen në mënyrë të koordinuar nga antarët e Mekanizmit të Referimit. Përveç vullnetit të mirë politik të njësive të vetëqeverisjes vendore – sidomos përsa i takon emërimit të specialistëve në pozicionin e Koordinatorëve Vendorë dhe sigurimin e qëndrueshmërisë së këtyre pozicioneve, nevojiten një sërë aktivitetesh për ndërtimin e kapaciteteve me qëllim përmirësimin e mbledhjes së të dhënave dhe vënien në efiçensë të këtij sistemi.

Informacioni për progresin në lidhje me statusin e grave dhe burrave në shoqëri është përditësuar periodikisht, evidentuar nëpërmjet statistikave tremujore dhe vjetore të përgatitura nga INSTAT, ministritë e linjës dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore. Botimet e dy viteve të fundit të INSTAT-it për "Femra dhe Meshkuj në Shqipëri" (respektivisht për vitet 2015 dhe 2016) janë përmirësuar dhe përmbajnë më shumë të dhëna të lidhura edhe me aspekte që nuk ishin marrë parasysh në botime të mëparshme[43]. Dy raportet e fundit qeveritare (Pekin+20 dhe Raporti i Katërt Periodik i Zbatimit të Konventës së CEDAW, të përgatitura dhe të dorëzuara në vitin 2014[44]) përmbajnë gjithashtu informacion të përditësuar për progresin në lidhje me statusin e grave në shoqëri.

Paralelisht me punën dhe përpjekjet për realizimin e aktiviteteve të planfikuara si pjesë e SKBGJ-DHBGJ/DHF 2011-2015, si dhe vlerësimit të zbatimit të saj, Qeveria e Shqipërisë ka

---

[36] Po aty: 2013 - Shkolla e Magjistraturës, mbështetur nga PNUD përfundoi një cikël trajnimi për 151 profesionistë ligjorë nga (69 gjyqtarë, 27 prokurorë, 11 ekspertë mjeko-ligjorë dhe 44 profesionistë të tjerë), ndërsa gjatë vitit 2012 u trajnuan edhe 51 profesionistë ligjorë (gjyqtarë dhe prokurorë)

[37] Po aty: 2012-2014 – me mbështetjen e PNUD, u trajnuan 339 anëtarë (210 gra) të Ekipeve Teknike Ndërdisiplinare, pjesë e mekanizmave të referimit.

[38] Po aty: 2012 - janë trajnuar 31 punonjëse gra nga Qendra Kombëtare për viktimat e DHF-së, me mbështetjen e PNUD. Në vitin 2014 u trajnuan 37 punonjës, si dhe punonjës të Qendrës Kombëtare (nga të cilët 28 ishin gra). Në periudhën janar-prill 2014 MMSR me mbështetjen e PNUD, trajnoi 51 punonjës për çështjet gjinore dhe koordinatorë vendorë për regjistrimin e kompjuterizuar të çështjeve të DHF-së.

[39] Burimi: MMSR, Sektori i Barazisë Gjinore, Prill 2016

[40] Nga Studimi: "Shqipëria - Raporti përfundimtar: Hartëzimi i shërbimeve mbështetëse kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave", rezulton se: ... "10 ofrues shërbimesh (ose 16.1%) deklarojnë se ofrojnë shërbime nëpërmjet linjave telefonike të ndihmës për gratë dhe vajzat viktima të dhunës, por 5 prej tyre janë shërbime të përgjithshme (drejtori të shëndetit publik apo spitale). Këto shërbime të përgjithshme deklarojnë se telefonatat nuk janë falas... Telefonatat në këto linja të ndihmës janë falas vetëm në dy shërbime nga 5 shërbime të specializuara gjithsej..."

[41] Po aty: "...Këshillimi nëpërmjet telefonit ofrohet nga 19 shërbime (ose38%)[41] nga të cilët 8 janë shërbime të specializuara ... Këshillimi ballë për ballë ofrohet nga 46 shërbime (ose 85.2%) nga të cilët 13 janë shërbime të specializuara ...".

[42] www.REVALB.org

[43] http://www.instat.gov.al/al/publications/librat/2016/femra-dhe-meshkuj-n%C3%AB-shqip%C3%ABri,-2016.aspx

[44] Shiko referencat e dhëna në faqet më sipër të këtij kapitulli të Strategjisë.

ndërmarrë edhe një sërë hapash të rëndësishëm në drejtim të hartimit të strategjive apo planeve kombëtare të veçanta për grupe të ndryshme. Këto dokumente kombëtare synojnë përmirësimin në tërësi të jetës, fuqizimin e zërit dhe rolit të grave në shoqëri, adresimin e nevojave dhe pabarazive të grupeve ndryshme si dhe trajtimin e tyre të barabartë dhe pa diskriminim, etj. Të rëndësishme për t'u përmendur si të hartuara në këto dy vitet e fundit janë: "Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale për Punësim dhe Aftësim 2014 -2020"[45], "Plani i Veprimit për mbështetjen e gruas sipërmarrëse 2014-2020"[46], "Paketa Bazë e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Parësor"[47], "Strategjia e Strehimit Social 2016-2025" dhe "Plani i Veprimit Strategjia e Strehimit"[48], "Dokumenti Politik i Përfshirjes Sociale 2016-2020"[49], "Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2015-2020 dhe plani i veprimit për zbatimin e saj"[50], "Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015 – 2020"[51], "Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë 2016-2020"[52], "Plani Kombëtar i Veprimit për Personat LGBT në Republikën e Shqipërisë 2016 -2020"[53], etj. Të gjitha këto, së bashku me "Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2015 -2020"[54] dhe një sërë dokumentesh ndërkombëtarë, janë mbajtur në konsideratë gjatë hartimit të SKBGJ 2016-2020, për një koordinim sa më efektiv të ndërhyrjeve dhe burimeve, si dhe shmangie të mbivendosjeve.

Së fundi por jo nga rëndësia, kur flitet për punën e deritanishme në drejtim të arritjes së barazisë gjinore dhe mbrojtjes nga dhuna me bazë gjinore e dhuna në familje, nuk mund të lihet pa përmendur roli i organizatave të shoqërisë civile dhe mbështetja nga organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Shqipëri. Është fakt tashmë që organizatat e shoqërisë civile, sidomos OJF-të e specializuara për ofrimin e shërbimeve, kanë luajtur dhe vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në këtë drejtim. Në një pjesë të mirë të rasteve ato jo thjesht plotësojnë detyrimet që duhet të përmbushen nga shteti, por edhe u paraprijnë disave prej tyre, përmes pilotimit të shërbimeve të ndryshme apo organizimit të aktiviteteve informuese, ndërgjegjësuese e trajnuese. Në lidhje me arritjen e barazisë gjinore, përvoja e bashkëpunimit me OJF-të si dhe zbatimi i modeleve të propozuara prej tyre, e ka lehtësuar vazhdimisht ndërhyrjen nga ana e shtetit, sidomos kur bëhet fjalë për fokusimin në njësitë e vetëqevrisjes vendore. Ndërsa shërbimet e ofruara nga OJF-të e specializuara për menaxhimin dhe trajtimin e rasteve që pësojnë dhunë me bazë gjinore e dhunë në familje, mbeten shpesh të vetmet mundësi. Shërbimet e strehimit, këshillimit, ofrimit të ndihmës ligjore falas, etj., në përqindjen më të madhe të rasteve vijojnë të

[45] Miratuar me VKM No. 818, date 26.11.2014
[46] Hartuar në vitin 2014 nga MZHETS me mbështetjen e UN Women, në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2014-2020, miratuar me VKM nr. 635, datë 1.10.2014, siç prezantohet në http://www.ekonomia.gov.al/files/documents_files/Mars_Newsletter_shqip.pdf
[47] Hartuar nga MSH, rishikuar dhe miratuar me V.K.M. nr. 101, datë 04.02.2015, ku prioritarizohet edhe çështja e dhunës ndaj grave dhe fëmijëve.
http://www.shendetesia.gov.al/files/userfiles/Shendeti_Publik/Paketa_e_rishikuar_e_miratuar.pdf
[48] Të dyja të hartuara nga Ministria e Zhvillimit Urban. Shiko:
http://www.zhvillimiurban.gov.al/al/dokumente/plane-pune-dhe-strategjite
[49] Miratuar me VKM nr.87 datë 03.02.2016
[50] Hartuar nga MMSR, miratuar me VKM 1071 datë 23.12.2015
[51] Hartuar nga MMSR, miratuar me VKM 383, date 06.05.2015
[52] Miratuar me VKM nr. 1072, datë 23.12.2015. Shiko:
http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/12/241.pdf
[53] Miratuar në 25 maj 2016
[54] Miratuar nga Këshilli i Ministrave, me VKM nr. 348, datë 11.5.2016 dhe botuar ne Fletoren Zyrtare nr. 86. Shiko
http://www.mod.gov.al/images/PDF/strategji2016/SKZHI_FINAL_QBZ.pdf

mbulohen nga këto organizata - puna e të cilave shpesh rrezikohet nga mungesa e mbështetjes financiare të vazhdueshme e të qëndrueshme. Kështu nevojitet angazhimi i strukturave shtetërore në nivel qendror dhe të vetëqeverisjes vendore për të përmbushur detyrimet sa iu takon shërbimeve duke bashkëpunuar dhe mbështetur punën e OJF-ve të specializuara. Mbështetja me burime dhe infrastrukturë, do të përmirësonte arritjen e objektivave në fushën e barazisë gjinore dhe kundër dhunës në familje.

ARRITJET E EVIDENTUARA NGA ZBATIMI I STRATEGJISË KOMBËTARE PËR BARAZINË GJINORE, REDUKTIMIN E DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE 2011-2015 DHE PLANIT TË SAJ TË VEPRIMIT[55]:

Synimi Strategjik 1: ***Forcimi i Mekanizmit Kombëtar të Barazisë Gjinore për nxitjen e zhvillimit të mëtejshëm të barazisë gjinore dhe garantimi i përmbushjes së të drejtave të njeriut për të gjithë shtetasit shqiptarë (gra dhe burra)***

- Janë bërë përpjekje të vazhdueshme për të përmirësuar kuadrin ligjor dhe politikat që nxitin zhvillimin e mëtejshëm të barazisë gjinore dhe garantojnë përmbushjen e të drejtave të njeriut për të gjithë shtetasit shqiptarë[56].
- Harmonizimi i legjislacionit kombëtar me standardet dhe kërkesat ndërkombëtare është përcaktuar si një proces kyç për të trajtuar më mirë nevojat gjinore të grave/vajzave dhe burrave/djemve në shoqëri.
- Është zhvilluar një kuadër gjithëpërfshirës ligjor dhe institucional që nxit barazinë gjinore dhe mbrojtjen e të drejtave të grave, megjithëse duhet të ndërmerren hapa të mëtejshëm, në veçanti për zbatimin e suksesshëm në praktikë (de-facto) të këtij kuadri.
- Ka një rritje të interesit të aktorëve të ndryshëm publikë për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Komiteti i CEDAW, megjithëse ky interes nuk pasqyrohet qartësisht në planet e veçanta të punës të përgatitura për këtë qëllim (që duhet të shoqërohen edhe me procedura të qarta monitorimi)

Synimi strategjik 2**:** ***Fuqizimi i grave dhe vajzave nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes së tyre në vendim-marrje.***

- Është përmirësuar ndjeshëm rritja e pjesëmarrjes së grave në nivel politik dhe vendim-marrës, përmes rritjes së kuotave gjinore nga 30% në 50% për kandidatet në listën e anëtareve të këshillave bashkiake.
- Është rritur përfaqësimi i grave në ushtri si për punonjëset civile ashtu dhe për forcat ushtarake; janë përgatitur politika dhe rregullore për promovimin e ngritjes në detyrë të grave në grada dhe përparimin në karrierë.
- Policia e Shtetit caktoi një kuotë 50% (gra) në politikën e saj të pranimeve në forcën policore, lançoi një fushatë rekrutimi vetëm për gratë, si dhe klasifikoi me sukses kandidatët mbi bazën e gjinisë.

Synimi Strategjik 3**:** ***Të sigurohet fuqizimi ekonomik dhe shoqëror i grave dhe burrave nëpërmjet adresimit të pabarazive gjinore që çojnë në varfëri dhe promovimit të përfshirjes sociale***

- Janë hartuar dhe zbatuar programet e punësimit të përmirësuara, duke rritur aksesin në trajnim dhe kualifikime profesionale, falas, për të gjitha gratë e papuna nën 25 vjeç; duke i kushtuar vëmendje reformimit të skemave të mbrojtjes shoqërore; etj.
- Është punuar për nxitjen e trajnimit profesional dhe punësimit të grave dhe vajzave nëpërmjet masave që mbështesin pjesëmarrjen e tyre në tregun e punës.

---

[55] "Raport Vlerësimi: Zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore, Reduktimit të Dhunës me Bazë Gjinore e Dhunës në Familje 2011-2015 dhe Planit të saj të Veprimit", përgatitur nga A. Plaku dhe M.Kocaqi, mbështetur nga PNUD me fonde të Qeverisë Suedeze, tetor 2015.

[56] Siç reflektohen të detajuara edhe në "Raportin Kombëtar për Zbatimin e Platformës për Veprim Pekin + 20", Prill 2014, botuar në http://www.sociale.gov.al/files/documents_files/Raporti_Final_Pekin+20_dt_30.04.2014.pdf

- Është përmirësuar kuadri ligjor lidhur me kredinë dhe sipërmarrjen e grave, me miratimin e Planit të Veprimit për mbështetjen e gruas sipërmarrëse për periudhën 2014–2020.
- Në zbatim të Planit të Veprimit për mbështetjen e gruas sipërmarrëse 2014-2020, Ministria e Ekonomisë krijoi fondin në mbështetje të sipërmarrëseve gra me një vlerë të përgjithshme prej 26,500,000 LEK që duhet të përdoret gjatë një afati katër vjeçar.

<u>Synimi Strategjik 4</u>: Rritja e ndërgjegjësimit ndaj dhunës me bazë gjinore, mbrojtja ligjore dhe administrative dhe mbështetja me shërbime për viktimat e dhunës dhe abuzuesit.

- Është përmirësuar ndjeshëm kuadri ligjor, por Shqipëria ende duhet të punojë në këtë drejtim - nevojiten përmirësime të mëtejshme për përmbushjen e kërkesave të konventave ndërkombëtare të miratuara, si dhe për të treguar tolerancë zero ndaj dhunës[57].
- Ekzistojnë përvoja pozitive për bashkëpunimin efikas ndërmjet shumë institucioneve/agjencive (p.sh. Mekanizmat e Referimit), por nuk reflektohet i njëjti nivel efikasiteti për të gjitha bashkitë ku janë krijuar këto mekanizma apo bashkëpunime ndër-institucionale, të cilat duhet gjithashtu të shtrihen në mbarë vendin.
- Ekzistojnë ofrues shërbimesh të përgjithshme dhe të specializuara për trajtimin e rasteve të dhunës ndaj grave e dhunë në familje. Megjithatë, jo të gjithë ofruesit e shërbimeve sigurojnë shërbime falas, në disa gjuhë, të disponueshme në nivel kombëtar dhe të përshtatura sipas nevojave specifike të grupeve[58]. Evidentohen mungesa në shërbimet mbështetëse të specializuara, si në ato ekzistuese[59] edhe në shërbime të reja që duhet të ngrihen.
- Ekziston një bashkëpunim shumë i mirë me donatorët dhe organizatat ndërkombëtare që rezultojnë të jenë edhe burimi kryesor i financimit për shumë aktivitete ndërgjegjësuese të organizuara jo vetëm nga OJF-të por edhe nga institucionet publike.
- Është punuar në drejtim të ofrimit të shërbimeve (programeve të trajtimit) për autorët e krimeve, por vlerësimi i efikasitetit të tyre do të kërkojë kohë.
- Ka filluar puna për angazhimin e burrave dhe djemve si partnerë të grave dhe vajzave për arritjen e barazisë gjinore dhe reduktimin e dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje. Megjithatë Plani Kombëtar i Veprimit 2014-2019 i hartuar për këtë qëllim ende ka mbetur një dokument i pa kostuar. Elementë të veçantë të tij janë adresuar nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme, sidomos në kuadër të fushatave të ndërgjegjësimit[60].

---

[57] Siç sugjerohen edhe në analizat e studimet e cituara në kapitullin "Situata Aktuale" të kësaj strategjie.

[58] Këto standarde duhet të merren në konsideratë gjatë investimit për përmirësimin e shërbimeve ekzistuese, si dhe për ngritjen e shërbimeve të reja. Për më shumë detaje lutemi referohuni tek Raporti Përfundimtar: "Shqipëria – Hartëzimi i Shërbimev kundër Dhunës ndaj Grave e Vajzave", Këshilli i Evropës dhe UN Women, Qershor 2015

[59] Për shembull në drejtim të strehimit: evidentohet jo vetëm mungesa e numrit të shtretërve të nevojshëm/mjaftueshëm për vendin tonë krahasuar me standartet e Këshillit të Evropës, por edhe mungesa e shërbimeve emergjente (strehëzat e emergjencës) për rastet e krizave. Për më shumë detaje lutemi referohuni tek Raporti Përfundimtar: "Shqipëria – Hartëzimi i Shërbimeve kundër Dhunës ndaj Grave e Vajzave", Këshilli i Evropës dhe UN Women, Qershor 2015

[60] Veprime të ndryshme të parashikuara në këtë plan janë shkrirë dhe bërë pjesë e veprimeve që parashikohen në Planin e Veprimit të SKBGJ 2016-2020, siç do të reflektohen me detaje në kapitullin përkatës të kësaj strategjie.

METODOLOGJIA

Procesi i hartimit të SKBGJ 2016-2020[61] mbështetet në një sërë **parimesh** ndërkombëtare dhe tek mësimet e nxjerra nga zbatimi i SKBGJ-DHBGJ/DHF 2011-2015.

- Procesi i hartimit (dhe vetë Strategjia) u mbështet tek ***angazhimet dhe standardet e BE-së, angazhimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare për barazi gjinore***, strategjitë e miratuara së fundmi si SKZHI dhe strategjitë sektoriale[62], duke përfshirë fuqizimin ekonomik.
- Metodologjia u përcaktua të jetë ***me pjesëmarrje dhe gjithëpërfshirëse***, duke i ofruar një numri të madh aktorësh mundësinë për të kontribuar me ide dhe komente[63].
- Angazhimi i një sërë institucionesh i jep kësaj Strategjie si autorësi ***Qeverinë e Shqipërisë***, jo thjesht Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Ministrive të linjës dhe (aty ku ishte e mundur) Njësive të Vetëqeverisjes Vendore iu dha mundësia që të kontribuojnë në hartimin e Strategjisë gjatë takimeve individuale apo tryezave konsultuese kombëtare. Përfaqësuesit e Grupit Ndërinstitucional të Punës, si dhe të ministrive përkatëse dhanë komente të hollësishme dhe rishikuan draftin e përgatitur, duke siguruar që përparësitë gjinore të strategjive të tjera sektoriale të përforcohen edhe më tej në SKBGJ 2016-2020. Komente dhe sugjerime u dhanë edhe nga organizata të ndryshme të shoqërisë civile, si dhe nga organizatat ndërkombëtare të angazhuara në çështje të barazisë gjinore dhe reduktimit të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje.
- Kjo Strategji nuk është një strategji ***vetëm*** për gratë, por një strategji që promovon barazinë gjinore ndërmjet ***burrave dhe grave*** (pavarësisht grupeve të veçanta që ata/ato mund t'u përkasin) dhe i përfshin burrat dhe gratë në luftën për t'i dhënë fund dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Suksesi i zbatimit të saj do të mbështetet tek të punuarit bashkërisht të burrave dhe grave, si dhe tek angazhimi me seriozitet i institucioneve përgjegjëse. Prandaj dhe në veprimet e parashikuara i jepet prioritet koordinimit, si dhe monitorimit e vlerësimit.
- Duke pasur parasysh ritmet e pabarabarta të zhvillimit në Shqipëri, u bënë përpjekje të koordinuara për të përfshirë edhe ***zërat e grupeve të marxhinalizuara, siç janë gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, gratë e moshuara, gratë dhe vajzat nga minoritetet etnike, komuniteti LGBT, etj*** përmes diskutimeve me ekspertë të fushës dhe organizata jofitimprurëse që i përfaqësojnë këto grupe, gjatë konsultimeve të realizuara.

Plani Kombëtar i Veprimit që shoqëron SKBGJ 2016-2020, u përgatit bazuar në:

a) gjetjet dhe rekomandimet nga Raport Vlerësimi: Zbatimit i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, Reduktimin e Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunës në Familje dhe Planit të saj të Veprimit 2010-2015,

---

[61] I cili u diskutua paraprakisht me MMSR dhe u lançua më pas gjatë mbledhjes së tretë të Këshillit Kombëtar për Barazinë Gjinore (KKBGJ) më 22 korrik 2015

[62] Pjesa më e madhe e të cilave u cituan edhe në kapitullin e mësipërm të kësaj strategjie (tek "Situata Aktuale" dhe puna e deritanishme).

[63] Gjatë gjithë procesit të hartimit, deri në përgatitjen e versionit përfundimtar (janar - qershor 2016). Qasja e propozuar synoi të përfshijë aktorët e interesuar në konsultime që në fillim të procesit dhe t'i mbajë ata të përfshirë dhe të informuar vazhdimisht. Komentet dhe sugjerimet e dhëna janë reflektuar në versionin përfundimtar të kësaj strategjie, përgatitur në qershor 2016.

b) hulumtimin e një sërë dokumentesh strategjikë në nivel kombëtar të miratuara nga Qeveria Shqiptare, për të harmonizuar masat e ndërmarra në lidhje me këto çështje dhe për të mos i mbivendosur ato,
c) objektivat dhe qëllimet apo masat e propozuara në një sërë dokumentesh dhe konventash ndërkombëtare, të rëndësishme në fushën e barazisë gjinore dhe për reduktimin e dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje.

Sikurse reflektohet edhe në objektivat dhe aktivitetet kryesore të propozuara në këtë Strategji dhe Planin e saj të Veprimit, është theksuar rëndësia e rolit koordinues dhe monitorues që duhet të luajë Sektori i Barazisë Gjinore në Drejtorinë e Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore në MMSR. Ky sektor duhet të mbështetet me burime të mjaftueshme, të jetë i qëndrueshëm dhe të ketë kapacitetet e nevojshme e të mjaftueshme që të mund të monitorojë zbatimin e të gjitha masave që synojnë arritjen e barazisë gjinore dhe reduktimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, të propozuara në këtë Strategji dhe në strategji të tjera kombëtare, të cilat listohen, por nuk kufizohen në sa mëposhtë:

- Strategjia Kombëtare Nërsektoriale për Punësim dhe Aftësim 2014-2020, miratuar me VKM Nr. 818, datë 26.11.2014
- Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale për Zhvillim Rural dhe Bujqësor në Shqipëri 2014-2020, miratuar me VKM Nr.709, datë.29.10.2014
- Plani i Veprimit për mbështetjen e gruas sipërmarrëse 2014-2020, në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2014-2020, miratuar me VKM Nr.635, datë 01.10.2014
- Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizim dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020, miratuar me VKM Nr.691, datë 29.7.2015[64]
- Strategjia Ndërsektoriale Reforma në fushën e të Drejtave të Pronësisë 2012-2020[65]
- Strategjia Kombëtare Sektoriale për Mbrojtjen Sociale 2016-2020, miratuar me VKM Nr. 1071, datë 23.12.2015
- Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptjanëve në Republikën e Shqipërisë, 2016-2020, miratuar me VKM Nr. 1072, datë 23.12.2015
- Plani Kombëtar i Veprimit për Personat LGBT në Republikën e Shqipërisë, 2016 -2020, miratuar më 25 maj 2016
- Ligji Organik për Funksionimin e Pushtetit Vendor, datë 18.12.2015, etj

Gjithashtu gjatë hartimit të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2016-2020 dhe Planit të saj të Veprimit u morën në konsideratë detyrimet që i lindin Qeverisë së Shqipërisë nga një sërë konventash ndërkombëtare, të tilla si:

- Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW)[66]
- Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara[67] *(KDPAK)*, ratifikuar nga shteti shqiptar me ligjin nr 108/2012.

---

[64] http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/PDF-2015/147-2015.pdf
[65] http://www.drejtesia.gov.al/files/userfiles/Strategjite_ndersektoriale/Strategjia_Reforma_ne_fushe_e-te-drejtave_te_pronesise.pdf
[66] Rezoluta 34/180 e datës 18 dhjetor 1979, hyrë në fuqi më 3 shtator 1981 dhe ratifikuar nga Shqipëria në 11 maj 1994
[67] http://www.un.org/disabilities/documents/convention/crpd_albanian.pdf, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së më 13 dhjetor 2006, hapur për nënshkrim më 30 mars 2007 dhe hyrë në fuqi më 3 maj 2008

- Platforma për Veprim e Pekinit (1995) dhe konkluzionet nga zbatimi i kësaj platforme nga shtetet antare në kuadër të 20 vjetorit të saj[68]
- Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ)[69]
- Rekomandimet për Shqipërinë mbi të drejtat e grave dhe barazinë gjinore të paraqitura në Rishikimin Periodik Universal 2014[70]

Po kështu u mbajtën parasysh edhe detyrimet që i lindin shtetit shqiptar për avancimin në çështje të barazisë, nga dokumente të tjerë të rëndësishëm në lidhje me procesin e integrimit evropian, të tillë si:

- "Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre antare", miratuar me Ligjin Nr. 9590 datë 27.07.2006[71]
- Direktiva 2006/54/EC, Direktiva 2002/73/EC, Rekomandimi i Këshillit 96/694/EC, siç paraqiten në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2016-2020[72]
- Rekomandimi Nr. (2002)5 i Komitetit të Ministrave, siç paraqitet në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2016-2020[73]
- Dokumenti "Angazhimi Strategjik për Barazinë Gjinore 2016-2019" i Komisionit Evropian[74]
- Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2016-2020 (PKIE) dhe Udhërrëfyesi (Roadmap) për barazinë midis burrave dhe grave (prioriteti 5)[75]
- Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit)[76], etj.

Të gjitha masat/aktivitetet e propozuara, pasi u vlerësuan dhe plotësuan edhe nga Grupi Ndërministror i Punës përgjegjës për hartimin e strategjisë, u detajuan më tej gjatë vlerësimit të efekteve financiare për zbatimin e kësaj Strategjie Kombëtare dhe Planit të saj të Veprimit 2016-2020.

Për të respektuar formatin standard të paraqitjes së Planeve të Veprimit që shoqërojnë Strategjitë, në të cilin renditja e institcioneve përgjegjëse e bashkëpunëtore në realizimin e veprimeve të planifikuara ka vetëm një kolonë ("Organi Përgjegjës"), është ndjekur kjo logjikë në paraqitjen e tyre: instucioni i parë i vendosur në këtë kolonë ka përgjegjësinë kryesore për të zbatuar

---

[68] http://ec.europa.eu/justice/gender-equality/files/documents/141211_bpfa_cc_en.pdf

[69] Objektivat 5: 5.1; 5.2; 5.3; 5.4; 5.5; 5.a; 5.b; 5.c; si edhe objektivat 1, 2,3,4,6.8.10.11,13,16,17 të cilët kanë përcaktuar tregues të ndjeshëm gjinorë. Shiko https://sustainabledevelopment.un.org/?menu=1300

[70] 7 Korrik 2014. https://documents-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/G14/076/77/PDF/G1407677.pdf?OpenElement

[71] http://www.integrimi.gov.al/files/documents_files/16-02-18-12-42-07MSA.pdf

[72] Kapitulli 19, fq 590. Shiko: http://www.integrimi.gov.al/al/dokumenta/dokumente-strategjike/plani-kombetar-per-integrimin-europian-2016-2020&page=1

[73] Kapitulli 19, fq 590. Shiko: http://www.integrimi.gov.al/al/dokumenta/dokumente-strategjike/plani-kombetar-per-integrimin-europian-2016-2020&page=1

[74] http://ec.europa.eu/justice/gender-equality/files/documents/151203_strategic_engagement_en.pdf

[75] http://www.integrimi.gov.al/al/dokumenta/dokumente-strategjike/road-map&page=1

[76] Nënshkruar më 11 maj 2011 në Stamboll, hyrë në fuqi në 1 gusht 2014. Shiko: http://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/210/signatures. Shqipëria e ka ratifikuar me Ligjin nr. 104/2012, "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës 'Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje".

veprimin/masën e parashikuar si dhe për koordinuar veprimet me institucionet e tjera që vijojnë të renditen në kolonë, të cilat kanë bashkëpërgjegjësi ose janë mbështetëse. Ndërkohë roli dhe puna e donatorëve dhe organizatave të shoqërisë civile, si mbështetëse e bashkëpunuese, renditet në fund, pas përshkrimit të çdo institucioni nën këtë kolonë. Ndaj dhe në leximin e dokumentit të Planit Kombëtar të Veprimit, duhet të mbahet në konsideratë fakti që: pavarësisht se roli i organizatave ndërkombëtare, donatorëve e shoqërisë civile është i domosdoshëm, ***në asnjë rast nuk mund dhe nuk duhet të lihet përgjegjësia për zbatimin e një aktiviteti të caktuar "vetëm" tek këto organizata***. Përgjegjësia mbetet e institucionit të parë të vendosur në kolonën "Organi përgjegjës", i cili duhet të ndërmarrë veprimet përkatëse planifikuese e koordinuese për zbatim, si dhe duhet të japë llogari për realizimin e çdo mase/veprimi (siç përshkruhet në kolonat përkatëse të PKV)

VIZIONI

Vizioni i Strategjisë, i perceptuar si orientim për përpjekjet jo vetëm të Qeverisë së Shqipërisë por edhe të mbarë shoqërisë për arritjen e barazisë gjinore dhe reduktimit të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, shkon përtej kohëzgjatjes së kësaj strategjie dhe sigurisht udhëheq zbatimin e saj.

Vizioni i Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore 2016-2020 është:
"Një shoqëri e cila vlerëson barazinë gjinore si kusht të domosdoshëm drejt zhvillimit të qëndrueshëm dhe synon drejt tolerancës zero kundër dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje".

Në mbështetje të këtij vizioni, janë formuluar edhe qëllimet kryesore strategjike me objektivat përkatëse.

QËLLIMET STRATEGJIKE[77], OBJEKTIVAT SPECIFIKE DHE PRODUKTET MADHORE

Qëllimi Strategjik 1: Fuqizimi ekonomik i grave dhe burrave.

Objektivi 1.1: Rritja e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës dhe reduktimi i hendekut gjinor

Rezultatet e pritshme: (i) Rritja e pjesëmarrjes në tregun e punës së grave dhe vajzave si pasojë e zbatimit të Strategjisë së Punësimit dhe Aftësimit 2014-2020 nën këndvështrimin gjinor duke u mbështetur nga masat e parashikuara në këtë objektiv specifik; (ii) rritja e aksesit të grave dhe burrave në programet e punësimit; (iii) përllogaritja e hendekut gjinor në pagë bazuar në Anketën Strukturore të Pagesave; (iv) zbatimi sa më efektiv i objektivave të Planit Kombëtar të Veprimit për Gratë Sipërmarrëse 2014-2020; (v) Një rëndësi të veçantë mban edhe rritja e përfshirjes së grave dhe vajzave në shkencë dhe inovacion si një mundësi për fuqizimin e tyre ekonomik.

Objektivi 1.2: Reduktimi i punës së papaguar të grave në familje duke rritur aksesin dhe cilësinë tek shërbimet sociale.

Rezultatet e pritshme: (i) reduktimi me 10% i punës së papaguar të grave si pasojë e rritjes së aksesit tek shërbimet sociale si çerdhe, kopshte, shërbime për moshën e tretë (sidomos për gratë e moshuara), shërbime për gratë dhe fëmijët me aftësi të kufizuara; shërbime për gratë rome, egjiptjane dhe gratë nga grupet e maxhinalizuara. (ii) vlerësimi i shërbimeve të ofruara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore në bazë të kompetencave dhe funksioneve te reja në kuadër të reformës administrativo-territoriale.

---

[77] Pas përgatitjes së "Raport Vlerësimit: Zbatimi i *Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, Reduktimin e Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunës në Familje 2011-2015* dhe Planit të saj të Veprimit", u propozuan katër drejtime strategjike, të cilat u diskutuan dhe miratuan nga GNP në mbledhjen e datës 15.02.2016

Objektivi 1.3: Fuqizimi ekonomik i grave në zonat rurale

Rezultatet e pritshme: (i) Përmirësimi i jetës së grave në zonat rurale duke reduktuar punën e papaguar në sektorin bujqësor për gratë; (ii) rritja e aksesit të grave në zonat rurale në shërbime si çerdhe dhe kopshte; (iii) rritja e formalizimit të punës në sektorin bujqësor për gratë; (iv) rritja e aksesit për shërbime shëndetësore cilësore; (v) rritja e numrit të grave fermere në skemat e suvencioneve dhe shërbimeve të extensionit; (vi) garantimi i gëzimit të të drejtave të pronësisë në tokën bujqësore.

Objektivi 1.4: Reduktimi i varfërisë së grave dhe vajzave

Rezultatet e pritshme: (i) identifikimi i tipologjive të feminizimit të varfërisë dhe marrja e masave për reduktimin e saj sipas zonave urbane dhe rurale; (ii) hartimi i masave konkrete për reduktimin e varfërisë tek gratë dhe rritjen e përfshirjes së tyre sociale.

Ky qëllim strategjik përmban objektiva specifike të mirë koordinuara duke mbështetur me aktivitete të gjitha masat ku është përfshirë integrimi gjinor, siç janë: (i) Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale për Punësim dhe Aftësim (2014-2020), (ii) Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale (2015-2020), (iii) Plani i Veprimit për mbështetjen e gruas sipërmarrëse (2014-2020), (iv) Strategjia e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (2014-2020). Në të gjitha këto strategji janë të përfshira një sërë aktivitesh dhe përcaktuar një sërë treguesish të ndjeshëm nga ana gjinore dhe buxhetimi i tyre. Si rezultat është sugjeruar referimi i objektivave specifikë me përqasje gjinore tek strategjitë përkatëse, duke forcuar rolin mbështetës dhe monitorues të Sektorit të Barazisë Gjinore në MMSR. Ndërkohë, ky objektiv strategjik do të synojë fuqizimin ekonomik të grave përmes aktiviteteve specifike për zonat urbane dhe ato rurale.

***Qëllimi strategjik 2**: Garantimi i pjesëmarrjes dhe angazhimit faktik dhe të barabartë të grave[78] në vendim-marrjen politike e publike.*

Objektivi 2.1: Rritja e vendim-marrjes në proceset publike të grave në nivel drejtues dhe proceset ligjvënëse, politikëbërëse dhe planifikuese në nivel qendror

Rezultati i pritshëm: (i) rritja e pranisë dhe kontributit të grave në 40% në jetën publike dhe politike në nivel qendror.

Objektivi 2.2: Rritja në 40% e përfaqësimit të grave në proceset publike në nivel drejtues të politikëbërjes dhe planifikuese në nivel vendor

Rezultati i pritshëm: (i) rritja e pranisë dhe kontributit të grave në politikëbërjen vendore në 40%, si pasojë e rritjes së numrit të tyre në këshillat bashkiake.

Ky qëllim strategjik synon të ***sigurojë një mbështetje dhe përmirësim*** të angazhimeve politike të ndërmarra tashmë e të përfshira në legjislacion (apo dhe që pritet të përfshihen me ndryshimet e

[78] Duke qenë se mbi moshën 18 vjeçare vajzat përfshihen tek grupi i "grave", sugjerohet të përdoret kjo terminologji në vend të grave dhe vajzave (si një mënyrë edhe për të ndryshuar pak gjuhën steriotipike që përdoret bazuar mbi mentalitetin e të etiketuarit "grua" një person në bazë të statusit civil).

reja në Kodin Elektoral në kuadër të procesit zgjedhor 2017). Ky drejtim do duhet të garantojë rritjen e vendim-marrjes në proceset publike të grave në nivel drejtues dhe proceset ligjëvënëse, politikëbërëse, planifikuese, monitoruese dhe vlerësuese në nivel qendror dhe atë të vetëqeverisjes vendore. Një rast konkret do të ishte garantimi i zbatimit të kuotës 30% në nivelin e emërimeve të administratorëve/reve të njësive të vetëqeverisjes vendore referuar Ligjit të Barazisë Gjinore dhe në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015 për Vetëqeverisjen Vendore. Po kështu, përfaqësimi i grave në nivelin vendim-marrës në këshillat bashkiake do të duhet të shoqërohet edhe në nivelin e njësive administrative me të emëruarit/rat nga Kryetarët/et e bashkive. Rëndësi këtu merr sidomos rritja e rolit të grave në bërjen e politikave dhe marrjen e vendimeve në nivelin e vetëqeverisjes vendore, ku të garantohet edhe përfaqësimi i grave nga grupet e marxhinalizuara, gratë me aftësi të kufizuara, gratë rome, gratë e moshuara. Politikat e hartuara do të duhet të reflektojnë ndjeshmëri gjinore. Një drejtim tjetër strategjik është edhe rritja e përqindjes së grave në nivel drejtues në organet e qeverisjes qendrore sidomos në proceset planifikuese, monitoruese dhe vlerësuese. Objektiva të tillë specifikë do të kishin efekte indirekt edhe mbi përmirësimin e situatës së grave rurale, pasi njësitë administrative mbulojnë zonat rurale.

***Qëllimi Strategjik 3**: Reduktimi i dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.*

Objektivi 3.1: Ndërgjegjësimi i shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Rezultati i pritshëm: Në fund të vitit 2020, numri i individëve të shoqërisë sonë të cilët besojnë se dhuna me bazë gjinore dhe dhuna në familje janë të papranueshme dhe të patolerueshme, i rritur me 30%[79].

Objektivi 3.2: Fuqizimi i mekanizmave të referimit si dhe shtimi/përmirësimi i shërbimeve mbështetëse të specializuara për mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Rezultatet e pritshme: (i) Në fund të vitit 2020, numri i bashkive me Mekanizëm Referimi të ngritur dhe funksional, i rritur me 52.5% (pra nga 29 bashki ku ekziston në vitin 2015[80] në 61 bashki në fund të vitit 2020[81]): (ii) Në fund të vitit 2020, numri i shërbimeve mbështetëse të specializuara i rritur me 53.8% (pra nga 13 shërbime mbështetëse të specializuara në vitin 2015[82], në 20 shërbime mbështetëse të specializuara në fund të vitit 2020).

---

[79] Nuk ka një bazë për të përcaktuar se sa është ky numër sot, apo se sa ka qenë në vitin 2015, ndaj dhe për matjen e këtij treguesi do të nevojitet fillimisht përcaktimi i këtij numri përmes një studimi (baseline), siç është planifikuar në PKV për t'u realizuar gjatë vitit të parë të zbatimit të SKBGJ 2016-2020. Objektivi specifik 3.1 do të quhet i përmbushur, vetëm nëse në fund të vitit 2020, nga ripërsëritja e të njëjtit studim perceptimi, do të kemi një rritje me 30% të numrit të individëve që besojnë se dhuna në familje është e papranueshme dhe e patolerueshme.

[80] Burimi: MMSR, maj 2016

[81] Kjo nënkupton një rritje me 32 të numrit të bashkive ku do të ngrihen Mekanizmat e Referimit

[82] Sipas Raportit "Shqipëria – Hartëzimi i Shërbimeve Mbështetëse kundër Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave", përgatitur me mbështetjen e Këshillit të Evropës dhe UN Women në qershor 2015, rezulton se në Shqipëri ekzistojnë gjithsej ***13 shërbime mbështetëse të specializuara*** në përputhje me kërkesat e Konventës së Stambollit, konkretisht: 9 strehëza, 5 qendra këshillimi (nga të cilat dy janë edhe strehëza ndaj dhe do numërohen vetëm 3 prej tyre) si dhe 1 program për dhunuesit. Në kuadër të zbatimit të PKV të kësaj Strategjie, synohet që deri në vitin 2020 të shtohen edhe 7 shërbime të tjera, konkretisht: 2 strehëza emergjence, 1 linjë kombëtare telefonike, 3 programe për

Objektivi 3.3: Ndëshkimi i dhunuesve dhe dhënia e mundësisë për rehabilitimin e tyre, përmes programeve të specializuara.

Rezultatet e pritshme: (i) Në fund të vitit 2020, legjislacioni penal për dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje i harmonizuar me dokumentet ndërkombëtarë të ratifikuar; (ii) Në fund të vitit 2020, numri i dhunuesve të ndëshkuar e më pas të rehabilituar, i rritur me 30%[83].

Ky qëllim strategjik është formuluar bazuar tek shtyllat dhe kërkesat e Konventës së Stambollit. Aktivitetet e planikuara synojnë gjithashtu përmirësimin e legjislacionit civil në kuadër të reformës së drejtësisë[84]. Veprimet kryesore fokusohen në tre drejtime: a) informim dhe parandalim, b) mbrojtje, siguri, rehabilitim dhe riintegrim për të dëmtuarat(it) nga dhuna, c) ndëshkim, zbatim korrekt i legjislacionit dhe mundësi për rehabilitim për dhunuesit(et). Siguria e viktimës; vendosja e dhunuesve përpara përgjegjësisë; ofrimi i shërbimeve të koordinuara, të qëndrueshme, të disponueshme e aksesueshme për të gjithë individët e dhunuar; si dhe pilotimi/shtrirja e programeve të reja në mbështetje të viktimave apo për trajtimin e dhunuesve, përbëjnë boshtin kryesor të këtij qëllimi strategjik. Duke qenë se shërbimet janë një komponent shumë i rëndësishëm i përmbushjes së këtij qëllimi strategjik duhet bëhet një harmonizim dhe gërshetim i tyre me ato çfarë janë parashikuar në Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2015 – 2020 (apo dhe në dokumente të tjerë strategjikë kombëtarë). Kështu do të mundësohet jo vetëm shtrirja e shërbimeve por edhe përmirësimi i standardeve dhe funksionimit të tyre, duke synuar përmbushjen e nevojave të të gjithë personave të dhunuar në familje, në mënyrë të veçantë të grave dhe vajzave nga grupe vulnerabël që pësojnë diskriminim e dhunim të shumëfishtë (si gra dhe vajza me: aftësi të kufizuara, varësi nga substancat, probleme të shëndetit mendor, orientim seksual ndryshe, nga minoritete etnike, të moshuara, emigrante, etj). Po kështu, një rol shumë të rëndësishëm luan edhe bashkëpunimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe marrja në konsideratë e të gjitha ndryshimeve si pasojë e reformës administrativo-territoriale dhe procesit të decentralizimit. Gjatë hartimit të objektivave dhe përcaktimit të aktiviteteve nën këtë qëllim strategjik, nuk është harruar edhe fakti që, vetëm ngritja e shërbimeve dhe numërimi i sasisë së tyre, nuk mjafton për të deklaruar që jemi në linjë me kërkesat dhe standardet për ofrimin e mbrojtjes apo trajtimit të kërkuar. Shërbimet duhet të shtohen, zgjerohen por edhe të përmirësohen duke u bërë lehtësisht të aksesueshme për të gjitha gratë dhe vajzat dhe individët që pësojnë dhunë në familje. Në to duhet të përmbushen kriteret e barazisë dhe mosdiskriminimit, si dhe duhet të plotësohen nevojat specifike të grupeve të veçanta (qasje dhe disponueshmëri, sidomos për gratë dhe vajzat me: aftësi të kufizuara, varësi nga përdorimi i substancave, probleme të shëndetit mendor, orientim seksual ndryshe, etj). Ndërkohë, vënia e

---

dhunuesit dhe 1 shërbim për fëmijët dëshmitarë të dhunës. Kjo nënkupton që nga 13 shërbime mbështetëse të specializuara në vitin 2015, do të kemi 20 shërbime mbështetëse të specializuara në fund të vitit 2020, pra një rritje prej 53.8% të tyre.

[83] Nuk ka një bazë për të përcaktuar se sa është ky numër sot, apo se sa ka qenë në vitin 2015, ndaj dhe për matjen e këtij treguesi do të nevojitet fillimisht vlerësimi i Programit të Këshillimit të Dhunuesve, siç edhe është planifikuar në PKV për t'u realizuar gjatë vitit të parë të zbatimit të SKBGJ 2016-2020. Objektivi specifik 3.3 do të quhet i përmbushur, vetëm nëse në fund të vitit 2020, nga ripërsëritja e vlerësimit të Progamit/programeve të Këshillimit për Dhunuesit, do të kemi një rritje me 30% të numrit të dhunuesve të ndëshkuar të cilët rehabilitohen përmes këtyre programeve.

[84] Synohet sidomos përmirësimi i Ligjit ekzistues nr 9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrdhëniet familjare" (i ndryshuar), apo përafrimi i Direktivës 2012/29/EU e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 25 Tetorit 2012: "Vendosja e standardeve minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit", siç është parashikuar edhe në PKIE 2016-2020 për t'u përmbushur brenda tremujorit të I-rë të vitit 2017.

dhunuesve përpara përgjegjësisë (që mund të evidentohet edhe përmes monitorimit të zbatimit të kuadrit ligjor) si edhe ofrimi i programeve trajtuese dhe rehabilituese për ta, gjithashtu është formuluar sipas parimeve dhe standardeve të nevojshme në respektim të dokumenteve ndërkombëtarë e legjislacionit kombëtar. Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim do të luajë edhe përmirësimi i mëtejshëm i legjislacionit kombëtar në kuadër të reformës në drejtësi, në përputhje me Konventën e Stambollit dhe konventa e dokumente të tjera ndërkombëtare.

Qëllimi strategjik 4: ***Fuqizimi i rolit koordinues dhe monitorues të Mekanizmit Kombëtar të Barazisë Gjinore, si dhe ndërgjegjësimi i shoqërisë për avancimin e barazisë gjinore.***

Objektivi 4.1: Përmirësimi i Sektorit të Barazisë Gjinore, në përputhje me rolin e tij sipas legjislacionit në fuqi dhe rekomandimeve të konventave e dokumenteve ndërkombëtare

Rezultati i pritshëm: (i) Në fund të vitit 2020, Sektori i Barazisë Gjinore në MMSR i fuqizuar (me strukturë të konsoliduar[85] dhe efiçente), në përputhje me rolin e tij koordinues dhe monitorues;

Objektivi 4.2: Konsolidimi i rrjetit të Nëpunësve Gjinorë në nivel qendror dhe të vetëqeverisjes vendore, si dhe garantimi i qëndrueshmërisë së tyre.

Rezultatet e pritshme: (i) Në fund të vitit 2020, numri i Nëpunësve Gjinorë në nivel qendror, me kohë të plotë, dedikuar tërësisht zbatimit të legjislacionit për barazinë gjinore[86], i rritur me 100% [pra nga 0 nëpunës gjinorë me kohë të plotë të emëruar në vitin 2015[87] (ose 0%), në 18 nëpunës gjinorë me kohë të plotë të emëruar deri në fund të vitit 2020 (ose 100%)]. (ii) Në fund të vitit 2020, numri i Nëpunësve Gjinorë me kohë të plotë në njësitë e vetëqeverisjes vendore, i rritur me 28% [pra nga 44 nëpunës gjinorë me kohë të plotë në nivel të vetëqeverisjes vendore në fillim të vitit 2016 (ose 72%)[88], në 61 nëpunës gjinorë me kohë të plotë në fund të vitit 2020 (ose 100%), pra një rritje me 17 nëpunës gjinorë (ose me 28%)]

Objektivi 4.3: Aplikimi i buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në zbatim të legjislacionit në fuqi, si dhe i planifikimit të ndjeshëm gjinor në të gjitha nivelet, në politikëbërje e vendim-marrje.

Rezultati i pritshëm: Në fund të vitit 2020, buxhetimi i përgjigjshëm gjinor si dhe planifikimet e ndjeshme gjinore në politikëbërje e vendim-marrje, të aplikuara në të gjitha nivelet e qeverisjes.

Objektivi 4.4. Ndërgjegjësimi i shoqërisë për pranimin e barazisë gjinore si kusht i domosdoshëm për zhvillimin e vendit.

Rezultati i pritshëm: Në fund të vitit 2020, numri i individëve të shoqërisë sonë të cilët besojnë se barazia gjinore është kusht i domosdoshëm për zhvillimin e vendit, i rritur me 30%[89].

---

[85] Nga një përbërje prej: 1 Shefe Sektori dhe 3 Specialiste në vitin 2015, në një përbërje prej: 1 Shefe Sektori dhe 4 Specialiste në fund të vitit 2020, pra shtimi i 1 specialisteje.

[86] I përmirësuar në kuadër të reformës në drejtësi dhe i harmonizuar me Acquis

[87] Aktualisht ekzistojnë vetëm Pika Fokale për Barazinë Gjinore në nivel qendror dhe asnjë nëpunës gjinor me kohë të plotë. Burimi: MMSR, Maj 2016

[88] Burimi: MMSR, Maj 2016

[89] Nuk ka një bazë për të përcaktuar se sa është ky numër sot, apo se sa ka qenë në vitin 2015, ndaj dhe për matjen e këtij treguesi do të nevojitet fillimisht përcaktimi i këtij numri përmes një studimi (baseline), siç është planifikuar në PKV për t'u realizuar gjatë vitit të parë të zbatimit të SKBGJ 2016-2020. Objektivi specifik 4.4 do të quhet i

Ky qëllim strategjik përmban objektiva që lidhen si me fuqizimin e Mekanizmit Kombëtar të Barazisë Gjinore dhe përmirësimin e kapaciteteve monitoruese të punonjësve në nivel qendror e vendor, ashtu edhe me harmonizimin e kuadrit ligjor që garanton trajtim të barabartë dhe përmbushjen e të drejtave njerëzore. Strukturat përbërëse të Mekanizmit Kombëtar të Barazisë Gjinore, sidomos Sektori i Barazisë Gjinore në MMSR, duhet të përgatiten dhe të zbatojnë me përgjegjshmëri funksionet koordinuese dhe monitoruese për fushat që mbulon SKBGJ 2016-2020. Përmirësimi i kapaciteteve të Sektorit të Barazisë Gjinore në Drejtorinë e Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore në MMSR si dhe koordinimi i punës monitoruese me GMPI respektive përsa i takon monitorimit të zbatimit të SKBGJ 2016-2020, do të ndikojë drejtpërsëdrejti edhe në përmirësimin e kapaciteteve analizuese, planifikuese e koordinuese të tij - gjë që jep impakt të drejtpërdrejtë në avancimin e barazisë gjinore dhe garantimin e zbatimit në praktikë të të drejtave dhe mundësive të barabarta. Fuqizimi i kësaj strukture do të mundësojë edhe monitorimin e zbatimit të një sërë politikash e masash të hartuara/që mund të hartohen edhe për gratë e vajzat që pësojnë diskriminim të shumëfishtë (si: me aftësi të kufizuara, nga minoritetet etnike, me orientim seksual ndryshe, të moshuara, etj). Ndërkohë nevojitet të investohet domosdoshmërisht edhe për fuqizimin e rrjetit të nëpunësve gjinorë në nivel qendor e atë të vetëqeverisjes vendore. Kjo nënkupton investim në burime njerëzore, financiare e infrastrukturore. Me fjalë të tjera, përmes zbatimit të këtij qëllimi strategjik synohet të sigurohet angazhimi për mbështetje konkrete jo vetëm politike por edhe financiare, për forcimin e mekanizmit të barazisë gjinore dhe përparimin në garantimin e të drejtave të barabarta për të gjithë individët në shoqëri.

---

përmbushur, vetëm nëse në fund të vitit 2020, nga ripërsëritja e të njëjtit studim percepimi, do të kemi një rritje me 30% të numrit të individëve që besojnë se barazia gjinore është kusht për zhvillimin e vendit

BURIMET FINANCIARE, HENDEKU FINANCIAR DHE MENAXHIMI I RISKUT

Metodologjia e kostimit të aktiviteteve PKV

Shpenzimet e nevojshme për zbatimin e PKV janë nxjerrë duke kostuar më vete secilin nga aktivitet e këtij plani veprimi.Metodologjia e zbatuar për llogaritjen e kostove paraqet një kombinim të metodave që mund të përdoren në rastet e strategjive ndërsektoriale. Metodologjia kryesore e përdorur është kostimi i bazuar në aktivitete (Activity Based Costing-ABC), metodologji e veçantë kostimi që identifikon aktivitetet në çdo institucion dhe cakton koston e çdo aktiviteti duke alokuar burime për të gjitha produktet dhe shërbimet në bazë të konsumit aktual për secilin aktivitet[90]. Buxheti u hartua mbështetur në koston e secilit aktivitet të pasqyruar në planin e veprimit, kohështrirjen dhe frekuencën e zbatimit të tij, si dhe numrin e përfituesve për aktivitete të caktuara.

Për llogaritjen e shpenzimeve për aktivitetet kryesore është vepruar si më poshtë:

Llogaritja e shpenzimeve për burime njerëzore bazohet në kohën e parashikuar për realizimin e veprimtarisë dhe një pagë mesatare ditore të një kategorie të caktuar të nëpunësve civilë.

Llogaritja e shpenzimeve për shërbime. Për këto aktivitete janë mbajtur parasysh kostot e shërbimeve të institucioneve përkatëse, bazuar në standardet e miratura.

Llogaritja e shpenzimeve për aktiviteteve që lidhen me hartimin dhe rishikimin e legjislacionit, monitorimin dhe funksionimin e strukturave të përhershme, etj. Për këto aktivitete gjatë llogaritjeve janë mbajtur parasysh shpenzimet e vazhdueshme që do të ndodhin, për shembull për pagat, kontributet e sigurimeve shoqërore, ekspertizë të huaj (kur është parashikuar në plan) dhe mjete konsumi.

Llogaritja e shpenzimeve për "aktiviteteve specifike" ose i iniciativave specifike të ngjashme. Në këto raste kostimi shpesh është i limituar, pra ai përdoret një herë të vetme, siç ndodh në rastin e studimeve, fushatave ndërgjegjësuese, programeve të trainimit, ekspertizës së huaj, etj. Vlerësimi i shpenzimeve për këto aktivitete u bazua kryesisht në natyrën e aktiviteteve dhe kostot që ofron tregu për shërbime të tilla.

Në llogaritjen e shpenzimeve për trajnime është mbajtur në konsideratë kosto e trajnimit për një person. Si kosto për njësi janë përdorur kostot e ASPAs dhe/ose kostot e aplikuara për trajnime të ngjashme në të shkuarën.

Për atë pjesë të aktiviteteve ku informacioni nuk ishte i plotë (si në rastin e studimeve apo fushatave të ndërgjegjësimit) është ndjekur metoda e vlerësimit për analogji, ose me fjalë të tjera janë marrë në konsideratë shpenzimet e bëra për aktivitete të ngjashme që kanë qenë përfshirë në strategjinë e viteve 2011-2015, ose produkte të ngjashme në PBA.

---

[90] Në shtojcën 4.3 janë llogaritjet e kostove për secilin aktivitet.

Buxheti dhe burimet financiare për zbatimin e PKV

Strategjia për Barazinë Gjinore do të zbatohet në periudhën 2016-2020. Për të mundësuar zbatimin e saj janë llogaritur shpenzimet e nevojshme për zbatimin e secilit aktivitet, objektiv specifik dhe qëllim strategjik.

Për të realizuar buxhetimin u konsultua dokumenti i PBA 2017-2019[91], buxheti për vitin 2016, buxhete për aktivitete të ngjashme të zbatuara nga institucione, donatorë apo organizata jo-fitimprurëse në të shkuarën.

Buxheti i përgjithshëm për zbatimin e strategjisë është reflektuar në disa forma:

- Buxheti i përgjithshëm sipas viteve për secilin aktivitet, objektiv specifik, qëllim strategjik dhe burimeve të financimit[92].
- Buxheti i detajuar sipas aktiviteteve, burimeve të financimit dhe institucioneve përgjegjëse[93].
- Gjatë llogaritjeve është mbajtur parasysh norma e inflacionit 2%.
- Në klasifikimin e financimeve nga buxheti janë përfshirë dhe fondet që NJVQV, Partitë Politike, Kuvendi i Shqipërisë dhe Institucione të tjera buxhetore duhet të alokojnë për zbatimin e kësaj strategjie. Pjesa më e madhe e shpenzimeve nevojitet për mbulimin e pagave të koordinatorëve të MKR dhe NGJV.
- Mbështetur në informacionin e disponueshëm janë identifikuar fondet e angazhura nga buxheti i shtetit dhe fondet që nevojiten për t'u siguruar nga donatorë dypalësh dhe shumëpalësh. Për financimin e një pjese të aktiviteteve ka donatorë potencialë, por nevojitet negocimi dhe lidhja e marrëveshjeve për financimin e aktiviteteve të caktuara.

Shpenzimet e nevojshme për zbatimin e PKV, me burime financimi nga buxheti i shtetit, buxheti i njësive të qeverisjes vendore, fondet e donatorëve dhe burime të institucioneve jobuxhetore, janë rreth **2,785 milion lekë** ose afërsisht **20.5 milion Euro**[94].

- Figura 2 tregon buxhetin në % sipas qëllimeve strategjike. Buxhetin më të madh e kërkon qëllimi strategjik 1 " Fuqizimi ekonomik i grave dhe burrave" (me 57.2% të shpenzimeve totale) dhe qëllimi strategjik 3 " *Zvogëlimi i dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje*" (me 33.9% të shpenzimeve totale).

Figura 2: Buxheti në % sipas qëllimeve strategjike

---

[91] Programit buxhetor afatmesëm 2017-2019, Fletore Zyrtare 136, 2016
[92] Për të dhëna të detajuara shih shtojcën 2
[93] Për të dhëna të detajuara shih shtojcën 3
[94] Kursi i këmbimit 1 Euro=136.0 lekë

Figura 2 paraqet shpenzimet e nevojshme për zbatimin e PKV sipas qëllimeve dhe objektivave specifike për të gjithë periudhën 2016-2020.

Figura 2. Shpenzimet sipas qëllime strategjike dhe objektivave specifikë



- 82.5% e shpenzimeve totale janë të alokuara në 3 objektivave specifikë. Shpenzimet më të madha do të bëhen për objektivin 3.2 "Fuqizimi i mekanizmave të referimit, si dhe i shërbimeve mbështetëse të specializuara për mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të DHBGJ&DHF". Shpenzimet për këtë objektiv janë sa 29.9% e totalit të shpenzimeve të PKV.. Shpenzimet bëhen kryesisht për dy aktivitete: 63.59% e shpenzimeve nevojiten për aktivitetin 3.2.7 "Zgjerimi i gamës së shërbimeve mbështetëse të specializuara në përputhje me kërkesat e Konventës së Stambollit si dhe shtrirja e tyre në mbarë vendin".
- Një aktivitet tjetër me shpenzime të mëdha është aktiviteti 3.2.2 "Emërimi i Koordinatorëve Vendorë në të 61 bashkitë në vend, të cilët të jenë me kohë të plotë dhe me një përshkrim

pune të përshtatur në përputhje me LDHF". Shpenzimet për këtë aktivitet mbulohen nga buxheti i NJVQV.

- Qëllimi strategjik 1 ka gjithashtu 2 objektiva për zbatimin e të cilave nevojitet 52.6% e shpenzimeve: Objektivi 1.2: "Reduktimi i punës së papaguar të grave në familje duke rritur aksesin dhe cilësinë tek shërbimet sociale, me 26.4% të totalit të shpenzimeve dhe Objektivi 1.3: "Fuqizimi ekonomik i grave ne zonat rurale" me 26.2% të shpenzimeve totale.
- Shpenzimet më të mëdha duhen për zbatimin e 2 aktivitete: Aktiviteti 1.2.4- çerdheve dhe kopshteve të ndërtuara sipas zonave ku këto institucione përkujdesi do të nevojiteshin më shumë me 42.2% 5ë të shpenzimeve të objektivit dhe aktiviteti 1.2.8- marrja e masave për ofrimin e shërbimeve sociale për fëmijët me aftësi të kufizuara me 38.1% të shpenzimeve totale të objektivit 1.2

Tabela 2 paraqet buxhetin që nevojitet për zbatimin e PKV, nga të gjitha burimet dhe sipas viteve fiskale. Buxheti që kërkohet për zbatimin e strategjisë ka një shtrirje pak a shumë uniforme për periudhën 2017-2019 (fig.2.1), ndërsa buxheti për vitin 2016 është llogaritur bazuar në fondet e alokuara nga buxheti dhe donatorët për këtë vit fiskal. Fondet që nevojiten për zbatimin e PKV në vitin 2020 janë pak më shumë se 1/4 e shpenzimeve totale.

Tabela 2: Kostot, burimet e financimit dhe hendeku financiar

PERSHKRIM	KOSTO E PËRGJITHSHME						FINANCUAR NGA			SHPENZIME TE PAMBULUARA (LEKE)		
OBJEKTIVAT	VITI 2016	VITI 2017	VITI 2018	VITI 2019	VITI 2020	TOTALI	Buxheti	Donatorët	Totali	Totali	Buxheti	Donatorët
Totali Qëllimi Strategjik 1	96.537.530.93	316.967.133.71	395.884.009.21	383.776.473.64	440.648.882.82	1.593.813.749.68	1.372.539.975.68	0.00	1.372.539.975.68	280.974.874.00	123.670.854.30	157.304.220.00
Totali Qëllimi Strategjik 2	7.412.915.80	8.722.385.39	7.205.348.31	6.178.838.62	6.470.219.74	36.089.503.86	20.112.430.86	1.101.800.00	21.214.030.86	14.875.472.99	4.183.153.29	10.692.319.69
Totali Qëllimi Strategjik 3	119.780.082.40	169.083.479.05	193.178.291.23	214.597.690.83	246.081.258.55	942.998.598.32	447.046.192.35	0.00	447.046.192.35	495.952.447.97	83.804.287.11	412.148.060.86
Totali Qëllimi Strategjik 4	28.704.677.43	29.921.843.28	38.010.959.97	50.518.295.10	73.070.951.25	212.229.537.03	207.395.307.03	1.890.800.00	209.786.007.03	2.444.460.00	1.562.480.00	1.891.990.00
TOTAL (1+2+3+4)	244.435.206.15	525.374.836.42	594.140.308.73	654.137.807.49	766.774.252.17	2.784.760.388.84	2.006.792.544.01	2.791.800.00	2.009.584.144.01	775.288.244.97	193.950.884.39	582.197.590.54
Buxheti ne etiri ndaj totalit ne %	8.8%	18.9%	21.3%	23.5%	27.5%	100.0%	99.9%	0.1%	72.2%	27.8%	24.9%	75.1%

- Aktivitetet e PKV do të financohen kryesisht nga Buxheti i Shtetit dhe buxheti për NJVQV. Nga llogaritjet rezulton që buxheti me burimet në dispozicion mund të mbulojë 72.2% të shpenzimeve të përgjithshme për zbatimin e PKV. 51.0% e buxhetit nevojitet për zbatimin e aktiviteteve në vitet 2019-2020.

- Kostoja financiare e mbuluar nga buxheti i shtetit, në të cilin përfshihet financimi nga Ministritë e linjës përgjegjëse për zbatimin e strategjisë dhe disa institucione buxhetore si (Kuvendi, Partitë Politike, AMSHC, INSTAT, Komunitetet Fetare, etj.) është rreth 1 miliard lekë ose sa 39.3% e aktivitete të financuara. Ndërsa kostoja financiare e mbuluar nga buxhetit i NJVQV është rreth 1.3 miliard lekë ose 47.4% aktivitete të financuara.

Hendeku financiar dhe menaxhimi i riskut

Hendeku financiar për zbatimin e aktiviteteve është rreth 775 milion lekë ose 27.8% e fondeve që nevojiten për zbatimin e PKV. Figura 3 paraqet hendekun financiar sipas qëllimeve strategjike.

Figura 3: Hendeku financiar sipas qëllimeve strategjikë



- Hendeku financiar për aktivitetet që duhet të financohen nga buxheti i shtetit është rreth 413 milionë lekë ose 37.2%. Ky hendek është parashikuar të financohet në masën 38.3% nga buxheti i shtetit dhe 61.7% nga fonde të donatorëve. Hendeku që planifikohet të financohet nga donatorët mbulon kryesisht shpenzimet për trajnime dhe asistencë teknike, studime, raporte vlerësimi, ngritjen dhe zgjerimin e gamës së shërbimeve për viktimat dhe të mbijetuarit e DHBGJ & DHF, etj. Donatorët potencialë për financimin e këtyre aktiviteteve janë agjencitë e Kombeve të Bashkuara si PNUD-i, UN Women, Swiss Cooperation,

- Hendeku financiar për aktivitetet që duhet të financohen nga buxheti i NJVQV është rreth 335 milionë lekë ose 21.4%. Ky hendek është parashikuar të financohet në masën 100% nga fonde të donatorëve që punojnë në nivel vendor për çështje të barazisë gjinore dhe DHBGJ & DHF. Financimi nga donatorët nevojitet kryesisht për monitorimin e shërbimeve në nivel vendor, ngritjen e shërbimeve të reja, fushata ndergjegjësuese, ngritje kapacitetesh për gratë këshilltare, etj.

- Hendekun më të madh e ka qëllimi strategjik 3 "*Zvogëlimi i dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje*" me 64.0%. Fondet nevojiten kryesisht për objektivin 3.2 (53.3% ndaj totalit të shpenzimeve): "Fuqizimi i mekanizmave të referimit, si dhe i shërbimeve mbështetëse të specializuara për mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të DHBGJ&DHF". 63.59% e shpenzimeve nevojiten për aktivitetin 3.2.7 "Zgjerimi i gamës së shërbimeve mbështetëse të specializuara në përputhje me kërkesat e Konventës së Stambollit si dhe shtrirja e tyre në mbarë vendin". Ky aktivitet zbatohen nga NJVQV dhe fondet për financimin e këtij aktiviteti për periudhën 2016-2018 do të kërkohen nga donatorët.

- Hendeku financiar për zbatimin e qëllimit strategjik 1 "*Fuqizimi i grave në tregun e punës*" është 33.67% e buxhetit total. Objektivi 1.3 "*Fuqizimi i grave në zonat rurale*" është objektivi që kërkon buxhetin më të madh dhe nuk janë të mbuluara nga buxheti 29.56% e shpenzimeve që nevojiten për këtë objektiv.

Tabela 2 paraqet hendekun financiar sipas qëllimeve strategjike dhe objektivave specifikë. Hendeku më i madh është në qëllimin strategjik 1, objektivi 3 dhe qëllimin strategjik 2, objektivi 2.

Tabela 2: Hendeku financiar sipas qëllimit strategjik dhe objektivave

	Objektivi 1	Objektivi 2	Objektivi 3	Objektivi 4	Totali
Qëllimi I	3.10%	2.59%	27.95%	0.03%	33.67%
Qëllimi II	0.57%	1.35%			1.92%
Qëllimi III	7.04%	53.31%	3.63%		63.98%
Qëllimi IV	0.03%	0.02%	0.00%	0.40%	0.45%

- Nevojat e pambuluara për fonde për objektivin 1.3 janë rreth 216.6 milionë lekë ose 27.95% e nevojave totale për fonde shtesë. Pjesa më e madhe e fondeve shtesë në objektivin 1.3 nevojitet për aktivitetet "Programe nxitëse për uljen e punës së paguar në sektorin bujqësor për gratë" (11.61% të totalit) dhe "Programe nxitëse për të diversifikuar punësimin e grave në zonat rurale" (9.67% të totalit).

- Nevojat për fonde shtesë ka gjithashtu Objektivin 3.2: Sigurimi i mekanizmave të referimit (53.31%).Në objektivin 3.2 aktiviteti që ka nevojat më të mëdha për fonde është "*Zgjerimi i gamës së shërbimeve mbështetëse të specializuara në përputhje me kërkesat e Konventës së Stambollit*" (40.70% të totalit).

Tabela 3 paraqet shpenzimet e financimit, burimet financiare dhe hendekun sipas njësive shpenzuese.

Tabela 3. **Kostot, burimet e financimit dhe hendeku financiar sipas njësive shpenzuese**

PERSHKRIM	KOSTO E PËRGJITHSHME						FINANCIARIMI A			SHPENZIME TË PAMBULUARA (LEKË)		
Institucionet Zbatuese	VITI 2016	VITI 2017	VITI 2018	VITI 2019	VITI 2020	TOTALI	Buxheti	Donatorët	Totali	Totali	Buxheti	Donatorët
Partia Politike	991,000.00	1,106,800.00	107,232.80	852,032.64	479,617.28	3,074,881.93	0.00	1,101,000.00	1,101,000.00	2,972,481.93	2,972,481.93	0.00
Institucione shtetërore (MSHMS, AMSHC, Kuvendi, Komisioni Felore, Shkolla e Magjistraturës, Zyra e Administrimit Gjyqësor	6,539,157.00	88,259,503.02	7,471,592.56	3,864,907.07	21,302,809.68	185,297,929.72	89,037,080.72	0.00	89,037,080.72	16,259,100.00	15,191,100.00	1,068,000.00
ARTAD/AP	1,645,000.00	2,255,200.00	2,445,904.00	2,805,047.28	2,132,494.14	10,044,411.34	6,345,000.00	0.00	6,345,000.00	4,289,415.34	1,310,671.34	2,978,744.00
NJVQV	136,451,708.00	288,222,124.00	349,684,826.00	408,103,603.28	488,396,770.35	1,660,858,297.63	1,210,944,441.95	0.00	1,210,944,441.95	355,994,855.68	32,003,000.00	323,894,855.68
Ministritë (MHRS, MZHETTS, MSH, MD, MEDHRAU, MAS, MZHAJ)	98,590,998.39	168,152,803.08	232,708,153.17	240,811,214.75	269,427,940.76	863,575,895.36	558,190,341.34	1,000,000.00	600,046,341.34	392,734,539.03	141,879,391.11	251,246,107.91
Të tjera	300,000.00	1,270,225.00	922,685.80	939,112.68	935,750.76	4,368,897.85	1,300,000.00	0.00	1,300,000.00	3,057,702.05	0.00	3,057,702.05
Totali	244,426,308.39	525,274,836.42	594,140,396.73	664,107,897.48	786,734,212.17	2,784,702,381.84	2,008,732,944.01	2,101,000.00	2,009,564,144.01	775,297,244.03	193,930,894.39	582,157,660.54

Zbatimi me sukses i SKBGJ dhe PKV 2016-2020 mund të vihet në vështirësi nga ekzistenca e disa risqeve, të cilat duhet të mbahen në konsideratë në mënyrë që të mos krijohen vështirësi reale në zbatimin e saj. Risqet kryesore të cilat mund të kenë efekt në zbatimin me sukses të strategjisë kanë lidhje me të dy nivelet e qeverisjes: Qeverinë Qendrore (Ministritë përgjegjëse për zbatimin e PKV) dhe Njësitë e Vetqeverisjes Vendore (kryesisht Bashkitë).

59.9% e shpenzimeve të PKV duhet të realizohen nga NJVQV. Këto shpenzime mbulohën në masën 78.6% nga buxheti i NJVQV dhe Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, Hendeku i përgjithëshëm financiar është 21.4% dhe është parashikuar të mbulohet në masën 91.0% nga

donatorët potencial si UNDP, Swiss Cooperation, Cooperacione Italiana, etj. Gjithashtu për zbatimin e disa aktivitete do të bashkëpunohet më OJF kombëtare dhe ndërkombëtare.

Risqet në nivel vendor lidhen kryesisht me angazhimin e NJVQV për të zbatuar aktivitetet pjesë e PKV dhe angazhimi i tyre për të kontribaur me të ardhurat e tyre financimin e aktivitete dhe/ose shërbimeve të planifikuara.

Financimet nga buzheti i shtetit janë klasifikuar në 3 grupe: Ministritë, Institucionet Buxhetore dhe ASPA/DAP. 62.8% e shpenzimeve të tyre janë të financuara në masën 99.8% nga buxheti i shtetit. Hendeku financiar për shpenzimet nga buxheti është në masën 37.2%. Ky hendek është planifikuar të financohet me fonde donatorësh në masën 61.7% dhe pjesa tjetër duhet të mbulohet nga buxheti i shtetit. Hendeku financiar që duhet të mbulohet nga buxheti është kryesisht në vitet 2019-2020.

i

Risqet në nivel Qendror lidhen kryesisht me angazhimin e të gjitha institucioneve përgjegjëse të përfshira në këtë Strategji dhe mbështetja e zbatimit të PKV me fondet e nevojshme për të mundësuar zbatimin e aktiviteteve të planifikuara.

Tabela 4. Buxheti dhe hendeku financiar në %

PËRSHKRIMI Institucionet Zbatuese	KOSTO TOTALE	SHPENZIME TE FINANCUARA	HENDEKU FINANCIAR
Partitë Politike	3,974,081.9	27.7%	72.3%
Institucione buxhetore (INSTAT, AMSHC, Kuvendi, Komunitet Fetare, Shkolla e Magjistraturës, Zyra e Administrimit Gjyqësor	105,297,020.7	84.6%	15.4%
ASPA/DAP	10,644,415.3	59.6%	40.4%
NJVQV	1,666,939,297.6	78.6%	21.4%
Ministritë (MMRS, MZHETTS, MSH, MD, MBZHRAU, MAS)	993,570,880.4	60.3%	39.5%
Te tjera	4,366,693.0	30.0%	70.0%
Totali	2,784,792,388.9		

Mungesa e fondeve nga buxheti dhe pamundësia për të siguruar fonde shtesë nga donatorët nuk rrezikon zbatimin e planit të veprimit në përgjithësi, pasi pjesa më e madhe e nevojave është kryesisht në aktivitetet që përfshihen në dy objektiva strategjikë.

MMSR ka realizuar takime më donatorët, por nuk ka marrëveshje të konkrete dhe për këtë arsyes shpenzimet janë konsideruar si hendek që kërkojnë financime nga donatorët

Hendeku financiar i aktiviteve që zbatohen nga Ministritë është në masën 39.5%. 63.9% e këtij hendeku është parashikuar të financohen nga donatorët potencialë. Hendeku që duhet të mbulohet nga buxheti i shtetit është planifikuar kryesisht në vitet 2019-2020, për t'i dhënë mundësi ministrive që të reflektojnë aktivitetet dhe shpenzimet në PBA pas miratimit të këtij dokumenti.

Shpenzimet e aktiviteteve të partive polike zënë rreth 0.14% të shpenzimeve totale. Hendeku financiar është 72.3%. Shpenzimet e vogla për zbatimin e këtyre aktiviteteve nuk rrezikojnë realizimin e tyre.

Hendeku financiar në vite jepet nga figura 4. Hendeku më i madh financiar është në vitin 2018. Ky hendek është parashikuar që të mbulohet kryesisht nga fonde të donatorëve. Ndërsa në vitet 2019-2020 një pjesë e hendekut duhet të mbulohet nga fonde të buxhetit (buxheti i shtetit dhe buxheti i NJVQV)

Figura 4: Hendeku financiar i shpërndarë në vite

PËRPUTHSHMËRIA E PRIORITETEVE STRATEGJIKE ME PLANIFIKIMIN BUXHETOR AFATMESËM

SKBGJ është një strategji ndërsektoriale dhe zbatimi i PKV lidhet me disa programe buxhetore. Strategjia zbatohet nga Ministritë linjës (8 Ministri)[95] , Institucionit buxhetore (7 institucione)[96], Partitë Politike, Komunitetet Fetare që financohen nga buxheti i shtetit. Një rol të rëndësishëm në zbatimin e PKV kanë NJVQV, të cilat financohen nga buxheti i NJVQV. Në këto rrethana PBA nuk është e vetmja reference për të parë përputhshmërinë e prioriteteve strategjike me planin buxhetor afatmesëm. Buxheti i NJVQV mbulon disa nga aktivitetet e parashikuara, pasi ka detyrime nga kuadri ligjor në fuqi.

Masat e parashikuara në PKV nuk dalin dhe/ose nuk janë të lidhura të gjitha si produkte më vehte në PBA (pasi ka masa që janë aktivitete të veçanta, projekte) dhe një produkt mund të lidhet me më shumë se një mase.

Në përgjithësi ekziston një përputhje midis prioriteteve strategjike të dhe planit buxhetor afatmesëm. Përputhshmëria e PKV, sipas qëllimeve strategjike me PBA paraqitet si më poshtë:

[95] MMSR, MAS, MSH, MD, MZHETTS, MBZHRAU, MF, MZHU
[96] ASPA, DAP, AMSHC, INSTAT, Shkolla e Magjistratur`s, Zyra e Administrimit t` Buxhetit Gjyq`sor, Kuvendi i Shqip`ris`)

Qëllimi strategjik 1 ka 4 objektiva specifikë për arritjen e të cilave janë parashikuar të zbatohen 35 aktivitete. Me zbatimin e aktivitete të këtij qëllimi janë ngarkuar 5 Ministri, INSTAT dhe NJVQV[97].

Aktivitetet e objektivit specifikë 1.1 lidhen me 4 programe buxhetore: MMSR (Kodi 01110 Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi dhe Kodi 10550 Tregu i punës); MZHETTS (Kodi 04130 Mbeshtetje per Zhvillim Ekonomik) dhe INSTAT (Kodi 01320 Veprimtaria Statistikore-INSTAT). Dy aktivitetet që financohen nga programi i Tregut të Punës nuk dalin si produkte më vete në PBA, por janë aktivitete të kuadër të produkteve të programit.

